

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7802 E diel 24 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Intervista e Ditës

Nga JAMIE SHEA



Jamie Shea ishte fytyra publike e fushatës së NATO-s për të dëbuar forcat serbe nga Kosova në vitin 1999. I admiruar në Kosovë dhe i fyer në Serbi, ai ishte ...
Vijon në faqen 21

NATO druhej mos Rusia pushtonte Kosovën

Opinion i Ditës

Nga KOÇO KOKËDHIMA



Situata politike në vend nuk është e spapritur. ZGJIDHJA e kishte parashikuar këtë që do të ndodhte që dy vite më parë. Ajo kishte mbështetur protestën e PD-së ...
Vijon në faqen 22

Nuk na duhen zjarrfikës të huaj politikë, por zgjedhje demokratike



“Të dridhen ata që kanë bërë pazare”

Basha: Protesta çdo të enjte para Kuvendit. Rama: Nuk jap dorëheqje

Kreu i PD: Rama do të kapë zgjedhjet e ardhshme. Përgjigjja: Berisha u pendua që nuk më hoqi qafe

Nga VALENTINA MADANI

Pas djegies së mandateve, opozita e bashkuar ka vendosur që të protestojë çdo të enjte përpara parlamentit të Shqipërisë duke mos lënë të qetë në marrjen e vendimeve mazhorancën e dalë sipas saj nga zgjedhjet e blera me krimin. ...
Në faqet 2-3

BILANCI/ NGA 16 MIJE KERKESA PER KOMPENSIM, MOREN PERGJIGJE 9 MIJE

PRONAT, ATP ÇON NE GJYKATE 7 MIJE DOSJE ME PROBLEME

Skadon afati 3-vjeçar për të vlerësuar dosjet, Agjencia e Pronave fton pronarët: Ejani tërhiqni dokumentet, filloni procedurat në Gjykatën e Shkallës së Parë



(Në foto) Prona (foto ilustruese)



Në faqen 10

PARKIMET NE VLORE

Akuza për shpërdorim detyre, Shpëtim Gjika përfundon sërish në gjykatë

Në faqen 7

KRYETARJA E LSI

Monika Kryemadhi: Protestat, vetëm rënia e qeverisë sjell stabilitet

Në faqen 5

KONCESIONI

Afera në Sharrë, ndërtuesit: Tarifa do bjerë në kurriz të konsumatorëve

Në faqen 11

HISTORIANI I NJOHUR

Bernd Fischer: Ikja e gjermanit të fundit? Data është vendim politik

Në faqen 12

“MILOSAO”



Aleksander Moisiu në kujtimet e aktorit austriak Fritz Eckhart

Suplement

EMRAT/ Ministria e Financave publikon dosjet e shqyrtuara në janar-tetor 2018

Lista e tretë, të përndjekurit që marrin paratë

Dokumentet që i mungojnë në dosje çdo trashëgimtari që do këstin e tretë

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfutues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit



të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfutues, por kanë mangësi në dokumentacion. “Gazeta Shqiptare” zbardh sot listën e përfutuesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar ...
Në faqet 8-9

KRIZA POLITIKE

INTERVISTA

Kryeministri: Berisha u pendua që s'më hoqi qafe kur ishte në qeveri

Në mikrofonin e gazetares italiane të Rainews Laura Tangherlini, kryeministri shqiptar Edi Rama shprehet se nuk ka ndërmend të dorëhiqet edhe pas vendimit të opozitës për dorëzimin e mandateve të deputetëve. Ai shprehet se është gati për dialog, por nuk do të largohet nga posti i kryeministrit. Sipas Ramës, opozita proteston nga dëshpërimi pasi e ka të sigurt se nuk fiton dot në zgjedhjet e ardhshme lokale. Ndërsa mbi raportin e OSBE me dyshimet e 20% të votës së manipuluar në zgjedhjet e fundit, kryeministri përgjigjet se nuk është e vërtetë, pasi ky raport flet për vëzhgime në përmirësimin e disa aspekteve të ligjit elektoral që të mund t'i japi më stabilitet sistemit. "Por në fund të fundit vota e manipuluar është diçka që nuk mund dhe ta përjashtoj se ekziston" - shprehet z.Rama. Kurse në një intervistë dhënë për "La Repubblica" Rama, akuzoi ish-kreu i PD-së, Berisha: "Është penduar që nuk më vrau kur ishte në qeveri, ai kështu është dhe unë nuk i përgjigjem. Më kujtohet që thoshte se më keq se komunistët janë anti-komunistët. Ja, Berisha i ka shërbyer në fillim komunizmit dhe pastaj u bë anti-komunist. Për fat të mirë ne nuk jemi më në epokën e plumbit, por të fjalës, të dialogut. Unë refuzoj logjikën e fushës së lojës ku duhet domosdoshmërisht të asgjësohet kundërshtari".

Z.Kryeministër, komuniteti ndërkombëtar deri më tani ka kritikuar vendimin e opozitës për të dorëzuar mandatet. Dhe kjo në një farë mënyre është të dashur në anë të qeverisë suaj, ju pse mendoni se është kjo mbështetje?

Mendoj se kjo mbështetje është për Shqipërinë dhe jo për qeverinë time, sepse është vendim i paarsyeshëm është një akt që nuk di të ketë ndodhur në demokraci ku populli përfaqësohet nga të zgjedhurit e tij, dhe ata duhet të përfaqësojnë vullnetin e popullit.

Opozita vijon të thotë se është një problem serioz në vend kultivimi dhe trafikimi i kanabisit, ju keni përsëritur disa herë se p.sh. në Lazarat problemi thuhet se është zgjidhur falë qeverisë tuaj. Si është situata në ç'plëkë jemi?

Vetëm pak kilometra nga këtu ishte një republikë e imponimit dhe e mbështetur nga politika nga qeveria e tyre që kultivonte dhe trafikonte

Protestat, Rama: Gati për dialog, por s'jap dorëheqjen

"Opozita e paqëndrueshme, s'mohoj blerjen e votave"



Kryeministri Edi Rama

PËR BERISHËN

"Është penduar që nuk më vrau kur ishte në qeveri, ai kështu është dhe unë nuk i përgjigjem. Më kujtohet që thoshte se më keq se komunistët janë anti-komunistët. Ja, Berisha i ka shërbyer në fillim komunizmit dhe pastaj u bë anti-komunist. Për fat të mirë ne nuk jemi më në epokën e plumbit, por të fjalës, të dialogut", -tha Rama për "La Repubblica".



Protesta e fundit e opozitës para Kuvendit

Ju keni thënë qartësisht se nuk keni ndërmend të dorëhijeni dhe se nuk do të ketë zgjedhje parlamentare këtë vit, në verë, siç është kërkuar nga opozita dhe se keni ndërmend të vazhdoni punën parlamentare dhe, mbi të gjitha, do vazhdoni të përfaqësoni ata njerëz që duke mos pasur më deputetë në Kuvend kanë mbetur jetimë për një përfaqësim.

Por si do ta bëni? Opozita është një pozicion lufte dhe kanë deklaruar se kanë ndërmend të protestojnë deri sa të mos ketë zgjedhje, deri sa ju nuk e keni lënë qeverinë dhe mbi të gjitha nuk duan as të vazhdojnë punën në parlament?

Ne kemi bërë një qeveri së bashku për të pasur zgjedhje të njohura nga të gjithë por me një kusht, kush fiton qeveris, kush humb rri në opozitë dhe mjaft të flitet keq për Shqipërinë dhe të kontestohen zgjedhjet. Ne kemi mazhorancën, jemi përpara në të gjitha sondazhet në një mënyrë ekzemplare, nuk mund, nuk mund të merret peng një komunitet dhe të thuash unë do bëj kamikazin nëse nuk më jepni atë që dua. Jemi gjithmonë gati për të dialoguar, jemi gati të dëgjojmë por sigurisht që duhet të qeverisim.

Ju cituat shifra, sondazhe dhe votimin e mazhorancës me të cilën jeni zgjedhur. Por është e vërtetë edhe se, këtë thotë opozita të paktën, se ka pasur dhe një përqindje votash që janë adresuar, OSBE fliste për një 20% të votave...

Nuk është e vërtetë. Raporti i OSBE thotë se duhet të adresohen disa aspekte që ligji elektoral t'i japë më shumë qëndrueshmëri sistemit. Pastaj në fund blerja e votave janë diçka që nuk mund të përjashtoj se ekziston.

Zyrtari i PS takon presidentin Stanishev

Balla në kongresin e PES: Qeveria ndryshon me zgjedhje, jo dhunë

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla mori pjesë në Kongresin Elektoral të Partisë Socialiste Europiane, në të cilën socialistët shqiptarë janë anëtarë. Balla njoftoi në "Fb" se ka zhvilluar takime me zyrtarë të lartë atje edhe për situatën politike në Shqipëri. Balla shprehet se qëndrimi i tyre është i qartë se asnjë parti politike në Shqipëri nuk ka të drejtë të dëmtojë perspektivën europiane. Sipas Ballës, ndryshimi i qeverisë në çdo demokraci mund të ndodhë



vetëm përmes zgjedhjeve dhe jo me dhunë. "Qëndrimi është shumë i qartë: "Për progresistët europianë ngjarjet e një jave më parë në Tiranë, përdorimi i dhunës kundër institucioneve të shtetit, e nxitir

haptazi dhe me forcë nga lideri i opozitës, si një metodë për marrjen e pushtetit dhe një përpjekje për delegitimimin e proceseve demokratike në Shqipëri është diçka e papranueshme dhe e patolerueshme. Ndryshimi i qeverisë në çdo demokraci mund të ndodhë vetëm përmes zgjedhjeve, e jo përmes kërcënimeve, bojkotit apo dorëheqjeve nga mandatet, e kursesi përmes përdorimit të çfarëdo forme të dhunës", -tha z.Balla.

mbi të gjitha frontet. Por në fund nuk duhet të më dëgjoni as mua as ata, duhet të dëgjoni Guardia di Finanza që në 2017 konfirmoi se thuajse nuk kishte më.

Në fjalimet tuaja të ditëve të fundit keni bërë një krahasim mes protestës së studentëve dhe asaj të opozitës, cila është diferenca?

Protesta e studentëve ishte një protestë e popullit, kishin të gjitha arsyet të cilat ne i dëgjua, ndërsa kjo nuk është një protestë e popullit. Kjo

është një protestë e një establishmenti që u mund thëllë dhe që ka arsye për të protestuar sepse nga njëra anë ata janë të dëshpëruar, sepse nuk mund të fitojnë. Janë zgjedhjet për pak muaj dhe nuk kanë shanse dhe, nga ana tjetër, ata janë shumë të shqetësuar për reformën rrënjësore të drejtësisë që ne kemi ndërmarrë me Komisionin Europian edhe me mbështetjen e SHBA-ve që po largon nga drejtësia të gjitha shefat e mëdhenj të një sistemi që ka

garantuar imunitet për politikanët dhe për këta këtu.

A mendoni se kontestimet e ditëve të fundit kanë dëmtuar imazhin e Shqipërisë në botë dhe ndoshta e ka bërë më të vështirë udhëtimin drejt integritimit europian?

Kjo sigurisht nuk i bën mirë as imazhit dhe as ekonomisë së vendit, sepse jemi në një periudhë të rritjes ekonomike më shumë se 4%. Ishin 3-4 orë që shkatërruan 3-4 vjet punë në sensin e imazhit.

AAAA

ZGJEDHJET

"Raporti i OSBE thotë se duhet të adresohen disa aspekte që ligji elektoral t'i japë më shumë qëndrueshmëri sistemit. Pastaj në fund blerja e votave janë diçka që nuk mund të përjashtoj se ekziston", - tha Rama.



TAKIMI

"Kryetari i bashkisë (Niko Shupuli i PD) është këtu i zgjedhur me votat e atyre. Të gjithë e shohim të vërtetën e ndryshimit të madh mes nesh dhe atyre. Përmeti është lënë pas dore"- tha Rama dhe në Përmet.



marijuanë, ashtu siç kishte edhe një heshjtje të përgjithshme mbi këtë fenomen në të gjithë vendin. Ne e nxorëm në dritë e diellit dhe goditëm



Kolegji i kryetarëve: Protesta çdo të enjte para Kuvendit deri në largimin e Ramës

Basha: Opozita protesta me 28 shkurt, 7 dhe 16 mars

"Duhet të dridhen ata që kanë bërë pazare"

Valentina Madani

Pas dëgjies së mandatëve, opozita e bashkuar ka vendosur që të protestojë çdo të enjte përpara parlamentit të Shqipërisë duke mos lënë të qetë në marrjen e vendimeve mazhorancën e dalë sipas saj nga zgjedhjet e blera me krimin. Seanca e ardhshme parlamentare pritet të jetë në 28 shkurt, kështu që në të njëjtën ditë është parashikuar edhe protesta te parlamentit. Duke folur pas mbledhjes së kolegjit të kryetarëve, kreu i PD-së Lulzim Basha njoftoi se protesta e radhës do të mbahet më datë 28 shkurt, kurse protesta e dytë më 7 mars. Të dyja këto protesta do të zhvillohen përpara godinës së parlamentit. Ndërsa më 16 mars opozita ka parashikuar të thërrasë një protestë mbarëkombëtare. Basha garantoj se protestat e opozitës nuk do të ndalen. "Në javën e ardhshme, më 28 shkurt dhe 7 mars organizohet protesta kombëtare para asamblesë kriminale që ka uzurpuar Kuvendin e Shqipërisë dhe më datën 16 mars do të zhvillohet një tjetër protestë e madhe kombëtare me qëllim rrëzimin e uzurpuesit të qeverisjes së Shqipërisë Edi Ramës, protesta që do të kenë për qëllim maksimalizimin e pjesëmarrjes qytetare, bashkimit qytetar dhe zemërimit qytetar për reagimin e papërgjegjshëm të klikës kriminale që është kapur duke vjedhur votat e shqiptarëve", -tha z.Basha.



Kreu i PD-së Lulzim Basha

DEKLARATA

"Më datën 28 shkurt, më datën 7 mars do të organizohen protesta kombëtare para asamblesë kriminale që ka uzurpuar godinën e Kuvendit të Shqipërisë. Më 16 mars do të zhvillohet një tjetër protestë e madhe kombëtare me qëllim rrëzimin e uzurpuesit të qeverisjes së Shqipërisë, Ramës, protesta që do të kenë për qëllim bashkimin e qytetarëve, për reagimin e papërgjegjshëm të klikës kriminale që është kapur duke vjedhur votat e shqiptarëve", -tha z.Basha.



Paloka: Safet Gjici në përgjime për blerje votash

Nënkryetari i PD, Edi Paloka deklaroi dje në "Kjo Javë" në News 24 se Presidenti i skuadrës së Kukësit, Safet Gjici ka dalë në përgjimet e ndërkombëtareve duke blerë vota në Kukës në favor të PS. Paloka u shpreh se janë 400 CD me përgjime të reja nga dosja '339'. "Po e them për ju për herë të parë. Safet Gjici në Kukës ka dalë në përgjimet e shërbimeve të huaja për blerje votash. Janë 400 CD të tjera që nuk janë zbardhur tek dosja 339. A do i zbardhi kjo prokurori? Kush t'i hetojë kjo prokurori që është sot? Këtyre CD-ve nuk do u dihet fati, nëse vazhdohet me këtë prokurori që kemi sot"- theksoi Paloka. Ai foli edhe për vendimin e opozitës për dëgjien e mandateve. Sipas tij, Rama do ikë me çdo lloj mënyre. "Ne u larguam nga një parlament ilegjitim. Ditën e protestës së 16 shkurtit ne e morëm mesazhin nga njerëzit. Nuk kishte më akt tjetër që mund të bënim. Në i kemi bërë të gjitha provat. Ai parlament nuk funksiononte më. Ne e dimë që është reagim ekstrem. Rama ka blerë votat në 4 qarqe. Ky njeri është bërë pengesë për vendin. Rama do largohet se s'bën. Ky vend nuk ka zgjedhje, nëse nuk largohet Rama. Rama do largohet me dhunë se vetë nuk ikën. Me dhunë nënkuptohet se nuk do marrim topat, por me të gjitha aktet që ai të largohet. Ai mund të vazhdojë të bëjë arrogantin, por do largohet"- tha Paloka.

"Rama ik", Berisha: Shqiptarët nisin protestën në Nju Jork

Sipas ish-kryeministri Sali Berisha, në mbështetje të protestës së opozitës së bashkuar, kanë dalë edhe disa shqiptarë që jetojnë në SHBA. Ai publikoi disa foto në 'Facebook' ku duken persona që mbajnë pankarta në duar me shënimin "Rama ik!". Berisha u shpreh se ata kanë protestuar ditën e premtë përpara konsullatës shqiptare në Nju Jork. "Nisin protestat kundër përfaqësive të narkoshtetit në botë, - shkruan Berisha. - Dje pasdite të rinj, ish të-burgosur dhe të përndjekur politikë dhe qytetarë të tjerë shqiptaro - amerikanë protestuan para konsullatës së narkoshtetit shqiptar në New York në mbështetje të protestave të mëdha të qytetarëve në Shqipëri kundër regjimit të kaktivitërisë në Tiranë. Protestuesit të revoltuar mbanin në dorë parulla "Rama ik" dhe "Zëri i Amerikës është Zëri i Lirisë, jo kazan". Spitalet si reparat ushtarak, mentaliteti i rrezikshëm ultracentralist i Rilindjes Miq, le të falënderojmë me mirënjohje të thellë të gjitha ata, vajza, djem, burra, gra, për protestën dhe solidaritetin e tyre vëllazëror me qytetarët e revoltuar në Shqipëri dhe le të ftojme shqiptarët kudo që janë të ndjekin shembullin e tyre.", - shprehet z. Berisha.



Bylykbashi: Rama ra në çark, PS të gjejë kryeministër tjetër

Kryeministri Edi Rama nuk mund të qëndrojë i vetëm në pushtet pavarësisht sakrificimit të bashkëpunëtorëve të tij. Ish-deputeti i PD, Oerd Bylykbashi në emisionin "Politika Online" shprehet se socialistët duhet të ndërrojnë kryeministrin pasi Rama nuk i shpëton dot situatës. Sipas Bylykbashit, provat për vjedhjen e zgjedhjeve bëjnë diferencën, mes skenarit të vitit 2009 për dëgjien e mandateve. Teksa e paralelizojnë sjelljen e Ramës me atë të dhelprës të rënë në çark, për ish-deputetin e PD, kryeministri do të largohet për t'i hapur rrugë zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

titet të blejë zgjedhjet e ardhshme. Zgjedhjet e ardhshme me narkomafian dhe Maduron e Ballkanit nuk do të ketë. Për këtë arsye, PD, opozita e bashkuar dhe të gjithë qytetarët do të marrin të gjitha masat, protestë pas proteste pa asnjë pengesë dhe frenim të zemërimit popullor derisa ta shporrin këtë bandit dhe hajdut nga karriget që ka vjedhur me krimin dhe paratë e kërimit, por që ka harruar se pushteti i takon dhe do t'i kthehet pronarit të vërtetë, sovranit që në Republikën e Shqipërisë është populli. Do

t'i kthehet përmes zgjedhjeve të lira, mekanizmi që ai ka frikë, mekanizmi që e tmerron dhe që e ka asgjësuar bashkë me Niçet, me Shullazët, me Dakot, me Sejdinët, me shokët. Pra, sezoni i protestave vetëm sa ka nisur, nuk do të ketë të

ndaluar, asgjë nuk do ta frenojë energjinë popullore për largimin e të keqes dhe për t'i dhënë Shqipërisë të nesërmen që meriton. Kjo e nesërme do të jetë pa Edi Ramën, pa narkotrafikanët, pa hajdutët oligarkë", -theksoi kreu i PD-së.

NJOFTIM ANKANDI

Përbaruesi Gjyqësor Lekë Dodaj shpalli ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të palës debitore, si më poshtë:

1. Garazhi nr.68/55-G9, zona kadastrale 3292, volumni 25, faqe 39, rrodohur në Shtëpi Tiranë në pronësi të z.Besnik Abaz Hoshafi.

Cmimi me të cilën do të fillojë Ankandi i Parë është 5,681 (pese mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) Euro.

Ankandë zhvillohet në datën 05.03.2019, Ora 16.00 në zyrën e Përbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj në adresën Rruga "Astrit Balluku", Ndërtesa 2, Hyrja 25, pranë Gjykatës së Prerit Gjyqësor Tiranë.

Për kontakt: 067 39 00 666, dhe në adresë emaili leke_dodaj@hotmail.com.

BLERJA E VOTAVE AKUZAT

Zëvendësambasadori Wilton: Po, ka pasur probleme me shitblerjen e votës

OSBE: Votat në Shqipëri u blenë, por nuk ndryshoi rezultati

"Ndoshta për dikë 50 lekë janë mjaftueshëm"

Valentina Madani

OSBE përmes zëvendësambasadorit Robert Wilton pranon se në Shqipëri janë blerë votat. Duke folur mbi akuzat për shitblerjen e votës ai theksoi se ky është një fenomen i konstatuar te disa subjekte politike, por që nuk ndikon në rezultatin e zgjedhjeve. Gjatë një bisede me të rinjtë në Shkodër ai foli rreth situatën politike në vend si dhe për fenomenin e shitblerjes së votës. Ai deklaroi se problemet e shitblerjes së votës ekzistojnë, por edhe pa ato rezultati do ishte i njëjtë. "Rama i patruar nga protesta e opozitës, foli për kërpuhën dhe drekonte në bregdet. Unë e kam parë më shumë të shqetësuar dhe gati për dialog gjatë protestave të studentëve. Ka patur probleme me shitblerjen e votës: Po! A mund të ndryshonin këto rezultatit e zgjedhjeve? Jo! A është vetëm një subjekt me këto probleme? Jo! Votuesit kanë patur mundësi për të shprehur zgjedhjen e tyre, pasi e kanë vetë në dorë. Ndoshta për dikë 50 lekë janë mjaftueshëm, por nuk i blen vetëm një subjekt. Gjatë protestës së të shtunës opozita ishte vetë përgjegjëse. Unë kritikoj përgjegjësit", -theksoi zëvendësambasadori i OSBE-së në Tiranë. Për Robert Wilton është e rëndësishme që në Shqipëri të ruhet stabiliteti. "Ne kemi presion pasi kërkohet stabilitet. Të ashtuqajturat skandalet në Shqipëri nuk janë unike. Janë të njëjtë me Europën Perëndimore, SHBA etj. Kur shoh diçka të keqe në Shqipëri mund të them që 3 herë me të keqe e shoh në Angli. Dallimi është retorika politike në Shqipëri ka arritur jashtë realitetit. Politikanët këtu i thonë një-tjetrit gjera që do i rrezikonin lirinë si ve për penale. Drejtësia dhe media nuk po ofron mbrojtje", deklaroi Wilton. Për shkak dhe të tensioneve politike, në Kuvend ende nuk janë miratuar rekomandimet e OSBE-ODIHR për ndryshimet në kodin zgjedhor. Ndërkohë më herët prezencia e OSBE-së në Tiranë i ka bërë apel partive opozitare që të tërhiqen nga vendimi



Zëvendësambasadori Robert Wilton

ROBERT WILTON

"Ka patur probleme me shitblerjen e votës? Po. A mund të ndryshonin këto rezultatit e zgjedhjeve? Jo. A është vetëm një subjekt me këto probleme? Jo. Votuesit kanë patur mundësi për të shprehur zgjedhjen e tyre, pasi e kanë vetë në dorë. Ndoshta për dikë 50 lekë janë mjaftueshëm, por nuk i blen vetëm një subjekt. Gjatë protestës së të shtunës opozita ishte vetë përgjegjëse. Unë kritikoj përgjegjësit", tha z. Wilton.

Blerja e votave, Vasili: Ramën e mban në pushtet krimi i organizuar

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili reagoi dje pas reportazhit të transmetuar nga televizioni Italian, RAI, ku u intervistua një nga trafikantët e Shijakut dhe që fliste për mënyrën se si me paratë e drogës blihen zgjedhjet në vitin 2017. "Për mënyrën e konferencës për shtyp Vasili tha se këto prova tregonin qartë se, sipas tij Rama bleu zgjedhjet në vitin 2017. "Pas dëshmiave të televizionit Italian RAI2, i cili hedh dritë për vjedhjen e votave në vitin 2017. Narkoshteti dhe mrijuana bleu zgjedhjet e 2017 dhe do i blejë edhe të radhës, këtë konfirmim krimi i organizuar. I bëri Edi Ramës të paraqitet në popull pa program duke kërkuar vetëm timonin sepse timonin donin narkotrafikanët", tha z. Vasili.



nin e donin narkotrafikanët. Telekomandën e Edi Ramës e mban në dorë krimi i organizuar. Ka një pyetje që e ngre dhe RAI për dosjen 339", theksoi z. Vasili. Ai shtroi pyetjen: Pse kanë frikë të ecin përpara me këtë dosje? "Çfarë shantazhesh personazhet e dosjes i bëjnë njëri-tjetrit? Çfarë të vërtetash tronditëse kanë për njëri-tjetrin. RAI2 konfirmoi që dosja mbahet e



AKUZA

"Narkoshteti dhe marijuana bleu zgjedhjet e 2017 dhe do i blejë edhe të radhës, këtë konfirmim krimi i organizuar. I bëri Ramës të paraqitet në popull pa program duke kërkuar vetëm timonin sepse timonin donin narkotrafikanët", tha z. Vasili. bllokuar. Sot i tërë populli shqiptar së bashku me opozitën janë vendosur në një krah dhe në krahun tjetër ndodhet një kryeministër mbështetur nga kriminelët. Sfidën e ka fituar dhe e fiton populli. Çdo sekondë i kaluar do jetë shkatërrimtar për Ramën. Shqipëria është e jona dhe nuk e vjedh dot Rama me dosjen 339", -u shpreh z. Vasili.

për të djegur mandatet. OSBE, vendimin e cilësoi si heqje dorë nga përgjegjësia dhe këshilloi që të mos ndërmerret asnjë përpjekje për të tronditur themelet e demokracisë përmes dhunës dhe që të mos ndryshohet procesi demokratik përmes presionit jodemokratik. Pas marrëveshjes politike të 18

majit, qeveria ngriti një Task Force ministore për të bashkërenduar veprimet qeveritare për të shmangur dhe, nëse do të ishte e nevojshme, për të ndëshkuar sjelljen e papërshtatshme të organeve administrative në procesin zgjedhor. Por sërisht pati akuzë nga opozita për blerjen e votave

nga mazhoranca qeverisëse. Opozita akuzon se PS-ja qëndron në pushtet me paratë e grupeve kriminale ndaj ka nisur dhe protestat kombëtare për largimin e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie transitore e cila të mund të garantojë zgjedhjet të lira për shqiptarët.



Gjatë një seance parlamentare

RAI 'hyn' në strofollën e trafikantit të drogës në Shijak: Pushteti blen

Televizioni italian Rai2 ka transmetuar një kronikë nga Shijaku, duke hyrë në strofollën e një trafikanti droge. Spikerja e televizionit Italian thotë se gazetari Leonardo Zelino ka takuar një trafikant droge dhe armësh. "Doreza për të mos lënë gjurmë gishtërinjsh, tekta prekim një kallashnikov, një armë që s'fal. "Armën e përdorim për të mbrojtur mallin dhe për të vrarë njerëz, nëse është e nevojshme. Këto blihen 150 euro e më pas shiten 4-5000 euro copa në Itali". Iglu nuk shet armë. Ai bën "biznes" kryesisht me barin, është një grossist marijuane. Për të mbërritur tek shtëpia e Iglit, takohemi fillimisht me ndërmjetësin, përfaqësitë të Durrësit dhe me makinë ecim rreth 30 km deri në Shijak. Në hyrje të zonës duhet ta fikim telekamerën dhe me kapuç në kokë derisa të mbërrijmë në shtëpinë e Iglit. "Këtu janë 10 kg. Kur vijmë blerësit, fillimisht u jap ta provojmë. Nëse u pëlqen, i çoj tek magazina dhe marrin sa kile duan". Është e pamundur ta shohim magazinën, më thonë, pasi kontrollat policore vitin e fundit janë bërë të intensishme. "Ky mall do përfundojë tek ju, në Itali". Shijaku është zona e Avdyllave, e supertrafikantëve, të arrestuar shpeshherë, që në telefon, para zgjedhjeve të fundit të 2017-s, flisnin për vota. Njëri prej vëllezërve Avdyllaj, në përgjimit e zbardhura nga Zëri i Amerikës, organi zyrtar i Shteteve të Bashkuara, falënderoi nga Vangjush Dako, kryebashkiaku i Durrësit dhe sekretari rajonal i Partisë Socialiste, që qeveris vendin. Dosja e përgjimeve ka ngecur në prokurorinë e përgjithshme tashmë prej dy vitesh, për shkak të lidhjes së hamendësuar me narkotrafikanët, për të cilën flet opozita parlamentare. "Natyrish, marijuana -lekë, lekët - pushtet, pushteti blen". "Në zgjedhjet e fundit kështu ndodhi?". "Po. Ashtu siç do të ndodhë edhe në zgjedhjet e ardhshme".



Shoqëria përmbirimore JUSTITIA

Shoqëria përmbirimore JUSTITIA shpall ankandën, faza e PARE, për shitjen e pasurisë së palajshme për të cilën ka vënë hipotekë BKT BANK, me këto të dhëna: Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të z. Adrian Sefer Kapllani diti.08.03.1969, zj.Merita Myzafer Kapllani diti.24.06.1970 Në vlerën 11.600.000 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë mijë) Lekë. Pasuria Apartament me sipërfaqe 120m² nr.pas.41115a-117 sh.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh 113 Durrës në pronësi të z. Adrian Sefer Kapllani diti.08.03.1969. Në vlerën 5.381.856 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë. Ankandë zhvillohet në datën 07.03.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbirimorit gjyqësor me adresë: Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.



Kryetarja e LSI: Rama ndihet si mbreti i Shqipërisë, por nuk ndalemi deri në rëzimin e tij

Protestat, Kryemadhi: Vetëm rënia e qeverisë sjell stabilitet

"Institucionet janë totalisht të shkatërruara"

Valentina Madani

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi beson se vetëm rënia e kësaj qeverie, që përfaqëson krimin e organizuar në Shqipëri, do të mund të sjellë stabilitet në Europë dhe në rajon. Kryemadhi në një intervistë për RaiNews, në të cilën sqaroi vendimin ekstrem të opozitës për djegjen e mandateve dhe vijimësinë e protestave deri në rëzimin e Edi Ramës nga pushteti. Gazetarja Laura Tangherlini, e cila ndoqi nga afër protestën e opozitës në Tiranë zhvilloi intervista me aktorët kryesorë politikë në vend mes të cilave edhe me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi. Ajo akuzoi se kryeministri po qeveris me krimin dhe se shqiptarët janë rrënuar për shkak të keqqeverisjes. "Institucionet janë totalisht të shkatërruara dhe është normale që ai të ndihet paksa si mbreti i Shqipërisë, duke menduar se ka mbështetjen e të gjitha institucioneve, por ky është një problem. Sjellja e tij është vërtetë një problem serioz, nëse ai nuk arrin të kuptojë se çfarë po ndodh, është problem i tij dhe jo problem i popullit shqiptar apo opozitës", - tha Kryemadhi.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

që kujdeset për fëmijët dhe ai është babai i shtëpisë, sigurisht ai mendon se aktiviteti ynë është pak i çudit-

shëm, pak si tepër agresiv nga pikëpamja e vendimeve që marrin (djegia e mandateve), por kjo është e vetmja

mënyrë që ne të ndezim shpresën se populli se diçka po ndryshon në Shqipëri", - u shpreh kryetarja e LSI-së.

AKUZA
"Institucionet janë totalisht të shkatërruara dhe është normale që ai të ndihet paksa si mbreti i Shqipërisë, duke menduar se ka mbështetjen e të gjitha institucioneve, por ky është një problem. Sjellja e tij është vërtetë një problem serioz, nëse ai nuk arrin të kuptojë se çfarë po ndodh, është problem i tij dhe jo problem i popullit shqiptar apo opozitës", - tha Kryemadhi.

SHKURTE

Mandatet, Boçi: Rama tenton ta spostojë debatin te zëvendësimi

Deputeti i PD, Luçiano Boçi iu përgjigj dhe kryeministrit Rama në lidhje me zëvendësimin e mandateve të opozitës në parlament. Kur s'kanë kaluar 24 orë nga momenti që Kuvendi i kërkoi KQZ-së zëvendësimin e vendeve të lëna bosh nga opozita, Boçi kujton se akti politik i opozitës nuk mund të konsiderohet si një procedurë e thjeshtë institucionale. Sipas Boçit, lënia e mandateve nuk ishte rrufe në qiell të hapur, por një formë e mosbindjes qytetare. "Sot në diskutim nuk është më mandati. Ai ka përfunduar. Nuk ka më lojë mandatesh. Sot në diskutim është sistemi i kalbur dhe i kriminalizuar, që mban në këmbë kufomat që japin lekstone demokracie e të cilëve llumi i zullumeve i duket si ujë i bekuar pagëzues. Mandatet u dogjën që të ndezin zjarrin e shpresës për drejtësi politike, sociale dhe ekonomike dhe për të përcëlluar aty projektet e regjimeve, që nusërojnë duke tradhëtuar votuesit e vendin. Miqtë ndërkomëtarë, pas përjetimit të pasojës së detyruar, duhet ta drejtojnë gishtin dhe mendjen tek shkakun dhe shkaqet. Demokracia shërohet duke flakur tej kancerin e sistemit dhe jo duke zbutur dhimbjet reaguese të një trupi që rrezikon vdekjen", - tha z. Boçi.

Përrjashtimi nga PD, Murrizi: Morën 1 mln shuplaka, bëjnë si të virgjër

Deputeti i PD-së, Myslim Murrizi reagoi sërish dhe pas vendimit të kryesisë së partisë për ta përjashtuar atë nga radhët e saj. Murrizi me tone të ashpër tregon arsytet pse nuk e dha dorëheqjen nga mandati. Demokratit shprehet se liderët aktual të PD-së kanë qenë refugjatë, kur ky i fundit ishte përballë socialistëve. Ndërkohë që thekson se PD e futi sistemin e blerjes së votave, ndërkohë që sot shprehet kundër saj. "Me vjen shumë neveri kur dëgjoj që flasin kundra blerjes së votës, ata që futën në sistem blerjen e saj. Sot shoh që është plotësuar e gjithë "polifoto" e atyre që u rrëzuan me votë në qershor 2013, përveç Dashamir Shehit. Nuk do habitesha fare nga vendimi i kryesisë së PDSH për të me shpallur armik, sepse me më shumë sesa gjysmën e tyre, kam qenë armik i baballarëve të tyre qysh në dhjetor '90. Me një pjesë tjetër kam qenë kundërshtarë i hapur në zgjedhjet e 31 marsit 1991, kur unë isha komisioner i PD, ndërsa ata kandidonin për bashkimin e rinisë së punës së Shqipërisë, ose ruanin votat e Ramiz Alisë në "Shkollën e Bashkuar", - thekson z.Murrizi.

Mediu flet nga Vjena: 5 arsytet përse protestojnë shqiptarët

I pranishëm në sesionin e përbashkët OSCE PA, kreu i republikanëve, Fatmir Mediu foli për protestën e zhvilluar në Tiranë. Në fjalimin e tij renditi një sërë arsytet që, sipas tij i shtynë shqiptarët të protestojnë. "1- Protestojnë për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Dhe kjo Asamble qëndron mbi këto parime. 2- Protestojnë kundër korrupsionit qeveritar, krimit të organizuar, bashkëpunimit të qeverisë me krimin, për të mbajtur pushtetin. Kjo Asamble bazohet në këto qëndrime. 3- Protestojnë për respektimin e Kushtetutës, pavarësinë e gjyqësorisë. Shqipëria ka më se 2 vjet pa Gjykatë Kushtetuese dhe përfundimisht 2 vjet pa Gjykatë të Lartë. Këtu pranë kam kolegët nga Gjermania dhe Amerika. Nëse dikush do të luante me Gjykatën Kushtetuese në Gjermani, kjo do të përbente një shqetësim të madh. Nëse Gjykata e Lartë nuk do të punonte, ky do të ishte një alarm i madh në SHBA. Nëse nuk



ALARMI

Nëse Gjykata e Lartë nuk do të punonte, ky do të ishte një alarm i madh në SHBA. Unë nuk mendoj se duhet të jetë ndryshe në Shqipëri. 4- Shqiptarët protestojnë kundër emigracionit masiv. 5- Shqiptarët kërkojnë një qeveri tranzitore, që të organizojë zgjedhje të lira dhe të ndershme.

mendoj se duhet të jetë ndryshe në Shqipëri. 4- Shqiptarët protestojnë kundër emigracionit masiv. 5- Shqiptarët kërkojnë një qeveri tranzitore, që të organizojë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Çështja e fundit. Me kënaqësi dëgjoja z. Lajçak, si kryetar i radhës i OSBE.

Ai theksoi, kur foli për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, se ndryshimi i kufijve nuk është zgjidhja. Besimi i është se ndryshimi i kufijve, apo loja për shkëmbimin e territoreve, do të rikthejë konfliktet në Ballkan dhe do të zgjojë konfliktet e vjetra", - theksoi z. Mediu.

I detyruan të firmosnin kontratat të dhuronin aksionet

Shantazh e dhunë biznesmenëve, ja si vepronte banda e gjobëvënësve në juglindje

TIRANË - Erjon Llapushi dhe Sajmir Frahulli (ky i fundit i njohur me nofkën "Murro") të cilët prej shumë se dy muajsh ndodhen në qelqitë e paraburgimit, dyshohen të jenë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal që përmes shantazhit e dhunës kanë detyruar biznesmenët të ndryshëm nga Pogradeci t'u dhurojnë aksione në kompani e tyre. Në dosjen e prokurorisë që disponon "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" janë zbardhur dëshmitë e aksionerëve të

DENONCIMI

Në dhjetor të 2018, dy vëllezër biznesmenë kanë kërkuar ndihmë nga institucionet, pasi ndiheshin të rrezikuar për jetën e tyre dhe të familjarëve. Ata kanë informuar prokurorinë se për këtë shkak kishin pezulluar edhe punën. Prokuroria për Krime të Rënda ka dyshime se pjesëtarët e tjerë të grupit kriminal që vijojnë të jenë në arrati po kërcënojnë biznesmenët që të tërheqin dëshmitë e tyre e për këtë arsye ka kërkuar ndihmën e policisë.

kompanive, ku iu shpjegohet hetuesve brutaliteti me të cilën vepronin anëtarët e bandës, me qëllim që ata të firmosnin kontratat për

dhurimin e aksioneve. Në dhjetor të 2018, dy vëllezër biznesmenë kanë kërkuar ndihmë nga institucionet, pasi ndiheshin të rrezikuar



Erjon Llapushi

Sajmir Frahulli

për jetën e tyre dhe të familjarëve. Ata kanë informuar prokurorinë se për këtë shkak kishin pezulluar edhe punën. Prokuroria për Krime të Rënda ka dyshime se pjesëtarët e tjerë të grupit kriminal që vijojnë të jenë në arrati po kërcënojnë biznesmenët që të tërheqin dëshmitë e tyre e për këtë arsye ka kërkuar ndihmën e poli-

cisë. Në dokumentet zyrtare të sekuestruara nga prokuroria rezulton se dy të dyshuarit Llapushi e Frahulli i kanë tjetërsuar një pjesë të aksioneve duke u dhuruar personave të tretë, gjithashtu, me precedentet penal. Banda në fjalë konsiderohet si më të rrezikshmit që operon në juglindje të vendit.

kl.ha.

Vendi nën pushtetin e erës, rëzohen 4 kamionë në rrugë e dëmtohen çatitë e banesave

Moti i keq, dy të rinj nga Buzhala e Pukës gjenden të vdekur në greminë

Familjarët e viktimave Kristaq Maka dhe Taulant Pjetri: Ishin në stan me bagëtitë

PUKË

Dy të rinj janë gjetur djete të pajetë në fshatin Buzhalë të njësisë administrative Qelëz në Pukë. Bëhet fjalë për 24-vjeçarën Kristaq Maka dhe 20-vjeçarën Taulant Pjetri, të cilët sipas familjarëve kanë qenë bashkë në stan me bagëtitë. Fillimisht kanë qenë banorët e zonës dhe familjarë të viktimave që kanë njoftuar policinë. Menjëherë pas marrjes së informacionit policia është nisur për në zonën e lokalizuar nga familjarët ku mund të kenë rënë dy të rinjtë. Ndërkaj, mësohet se Kristaq Maka kishte shkuar të shoku i tij që po ruante bagëtitë. Sipas burimeve policore, dyshohet që dy të rinjtë e pafat janë rrëzuar në një rrëpirë në zonën e largët malore të bjeshkëve të Murgës dhe kanë rënë në greminë. Policia, të afërmit dhe banorë të zonës kanë nisur punën për nxjerrjen e trupave të pajetë, por deri në orët e vona të mbrëmjes të së shtunës kjo nuk është bërë e mundur. Kjo për shkak të terrenit malor dhe kushteve të këqija atmosferike. Pavarësisht se shkaqet dhe rrethanat e vdekjes janë ende të paqarta, paraprakisht dyshohet se 24-vjeçarja Maka dhe shoku i tij 20-vjeçar, Taulant Pjetri të kenë humbur jetën për shkak të motit të keq. Konkretisht, dyshohet që dy të rinjtë të jenë rrëzuar në greminë si pasojë e erërave të forta.

MOTI I KEQ

Fundjavë risolli acarën dhe dëborën thuasjë në të gjithë territorin vendit. Moti i keq i shoqëruar me dëborë në zonat malore dhe erëra të forta ka shkakuar probleme serioze në disa



Kamioni i rrëzuar në Pukë

zona të vendit si në Elbasan, Lezhë, Pukë e Shkodër, sidomos në furnizimin me energji elektrike dhe jo vetëm. Si pasojë e erës së fortë në shumë zona të rrethëve Elbasan, Librazhd dhe Peqin janë shpërndarë çati banesash apo magazinash të ndërtruara pjesërisht nga shkatërruar pjesërisht çati banesash apo magazinash të ndërtruara me konstrukcion llamarinë. Era e fortë ka krijuar probleme në qarkullimin me shpejtësi të automjeteve dhe përdoruesit e rrugës janë këshilluar nga policia të bëjnë kujdes për evitimin e aksidenteve.

Lezha, dje ishte nën pushtetin e erërave. Tre kamionë janë përmbysur për shkak të erës së fortë në këtë rreth. Mësohet se kamionët kanë qenë duke lëvizur në akse të ndryshme. Si pasojë e aksidentit, njëri nga drejtuesit e mjeteve ka pësuar dëmtime të lehta dhe ka marrë mjekimin në spitalin e Lezhës. Po dje një tjetër kamion është përmbysur në veri të vendit si pasojë e motit të keq me erëra të forta. Mësohet se kamioni është përmbysur në aksin rrugor Pukë-Shkodër; në vendin e quajtur Qafë Qelë. Nga përmbysja e kamionit anës rrugës nuk ka persona të lënduar, por vetëm dëme materiale. Nder-



sa, në Vaun e Dejës është dëmtuar dhe është bërë e pakalueshme ura që lidh fshatrat e Vig dhe Mnelë. Gjithashtu, në Vaun e Dejës janë dëmtuar era e fortë çatitë e disa banesave si dhe serat. Si pasojë e erës së fortë, në Portin e Shëngjinit është penguar dalja e anijeve në det. Më e qetë është paraqitur dje situata në Portin e Durrësit, ndonëse autoritetet paralamëruan vonesa të trageteve. Megjithatë Durrësi është zgjuar mëngjesin e së shtunës i zbardhur nga dëbora. Në qarkun e Korçës temperatura kanë arritur deri në -10 grade. Mjetet borëpastruese kanë filluar me pastrimin e rrugëve, ku këshillohet për-

dorimi i zinxhirëve në një pjesë të rrugës Korçë-Dardhë, në Qafën e Qarrit dhe në aksin Korçë - Voskopojë. Në Llogora dëbora ka vështirësuar qarkullimin, i cili po bëhet me zinxhirë. Nisur nga situata e krijuar, policia Rrugore ka pezulluar lëvizjen e kamionëve me mbulesë deri në njoftim të dytë në aksin rrugor Lezhë - Mabe. Njoftimi erdhi për shkak të rrëzimit të katër kamionëve gjatë ditës së djeshme. Policia ka apeluar të gjithë drejtuesit e mjeteve këtë aks dhe në rrugën Tepelenë-Fier të ngadalësojnë shpejtësinë dhe të tregohen të kujdesshëm, për shkak të intensitetit të fortë të erës.

SHKURT

Ndërhyri të shuante sherrin, mjeku goditet me tullë në kokë

DURRËS - Një incident i rëndë është shënuar ditën e djeshme në spitalin e Durrësit, ku një mjek është goditur me tullë në kokë. Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur në urgjencë, ku mjeku roje ka ndërhyrë për të ndarë tre persona, të cilët po ziheshin. Mësohet se tre personat, dy nga të cilët ishin nga e njëjta familje, kishin të afërmit e tyre të shtruar në spital. Familjari i një tjetër pacienti u kërkoi dy personave të tjerë që të mos diskutonin me zë të lartë dhe në këtë moment, përplasja nga verbale ka përfunduar në fizike. Mjeku Kola ka ndërhyrë për t'i ndarë, por njëri prej tyre e ka goditur me tullë në kokë duke i shkakuar dëmtime. Në lidhje me këtë ngjarje janë ndaluar dy persona, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim.

Shpërndante drogë në shkollë, bie në pranë 32-vjeçari

LUSHNJE - Një 32-vjeçar nga Lushnja ka përfunduar në pranë, pasi dyshohet se shpërndante drogë në shkollë. Specialistët për hetimin e narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier kanë arrestuar në flagrancë shtetasin me iniciale M.B.. Arrestimi i të riut u bë pasi në ambientin përreth shkollës u kap me disa doza lëndë narkotike, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Materialet i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Nxitja për përdorimin e drogës".

Shkojnë për një predhë, zbulojnë arsenal municionesh

PUKË - Një ditë pas gjetjes së një predhe në Pukë nga punonjësit e gjelbërimit, Ministria e Mbrojtjes dërgoi dje një ekip EOD (explosive ordnance disposal) të Forcave të Armatosura në këtë qytet. Mësohet se gjatë kërkimeve dhe këshjës së zonës, xhenerierët e Forcave të Armatosura zbuluan 40 granata dore defensive, 6 granata dore ofensive si dhe një granatë dore me bisht. Nga verifikimet paraprake, dyshohet që këto municione të kenë dalë nga depot e FA dhe të jenë hedhur në zonë gjatë trazirave të vitit 1997, duke u shndërruar në një rrezik serioz për jetën e banorëve.

Kompania e huaj u tërhoq pas protestës së qytetarëve, bëri padi në Gjykatën e Arbitrazhit



VLORË

Nuk kanë të sosur telashet për ish-kryetarin e Bashkisë së Vlorës, Shpëtim Gjika. Jo shumë larg zgjedhjeve lokale në vend, ish-kryebashkiakut i hapen sërish probleme me drejtësinë. Mësohet se prokuroria e qytetit bregdetar ka mbyllur hetimet dhe ka dërguar të pandehur në gjykatë Gjilkën, këtë herë për dyshimet se ka shpërdoruar detyrën gjatë kohës që mbante detyrën e kreut të bashkisë. Prokuroria dyshon se Gjika bashkë me shtatë punonjës të tjerë të bashkisë kanë shkelur ligjin gjatë dhënies me koncesion për parkimet me pagesë në 24 rrugë në qytetin e Vlorës. Siç dyshon prokuroria, Gjika bashkë me 7 punonjës të tjerë kanë shkelur ligjin gjatë dhënies me koncesion për parkimet me pagesë në 24 rrugë në qytetin e Vlorës. Siç parashikohet në kontratë, duke nisur që nga 2015, për 15 vitet e ardhshme qytetarët duhet të paguanin 50 lekë për çdo orë parkimi, ndërsa bashkia do të merrte 10 milionë lekë për çdo vit nga kompania private. Dhënia me koncesion një firme që kishite adresën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u miratua me unanimitet nga Këshilli Bashkiak, por imenjëshëm ishte reagimi i qytetarëve, të cilët kundërshtuan hapur bllokimin e automjeteve të tyre. Në atë kohë, qytetarët vlonjatë kanë protestuar disa herë duke kërkuar anulimin e koncesionit, pasi sipas tyre mungojnë semaforët, vijëzimet, ndërsa rrugët janë jashtë standardeve për të pretenduar parkime me pagesë dhe këto shërbime duhet të kryheshin nga kompania fituese. Kundërshtimi nga ana e qytetarëve të Vlorës çoi në tërheqjen e kompanisë, e cila ka paditur Bashkinë e Vlorës në Gjykatën e Arbitrazhit. Prokuroria dyshon

Koncesioni i parkimeve me pagesë në Vlorë, Shpëtim Gjika përfundon sërish në gjykatë

Prokuroria: Ish-kryebashkiaku dhe shtatë punonjës akuzohen për shpërdorim detyre



Ish-kryebashkiaku Shpëtim Gjika



Faksimile e dosjes penale

PRECEDENTI

Katër vite më parë, kryebashkiaku Shpëtim Gjika u akuzua dhe dënua nga Gjykata e Shkallës së Parë për lejen e ndërimit të një pallati 11-katësh në qendër të qytetit të Vlorës. Pas një procesi të gjatë ai u shpall i pafajshëm në Gjykatën e Apelit në Vlorë. Vendimi u dha në nëntor të vitit që shkoi. Një ditë përpara përballjes me KPK-në, Alma Liçaj dhe dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues në Apelin e Vlorës rrëzuan dënimin e shkallës së parë, duke e çliruar nga akuzat ish-kryetarin e Bashkisë së Vlorës.

se përfshirja në kontratë e detyrimit të Bashkisë së Vlorës për t'i paguar kompanisë së paku 20 milionë dollarë në rast të ndërprerjes së kontratës ka shkaktuar dëm ekonomik. Por, ish-kryetari i Bashkisë së Vlorës, i pyetur nga prokurorët për këtë fakt, i ka hedhur poshtë qëndrimet e akuzës, pasi sipas tij,

nuk ka veprë penale për sa kohë nuk ka dëm ekonomik. Kontrata koncesionare u firmos në mars të vitit 2015, pak muaj para zgjedhjeve lokale, ku Gjika nuk u rikandidua më nga Partia Socialiste në qytetin bregdetar të Vlorës. Kjo nuk është hera e parë që Gjika përfundon si i pandehur në gjykatë. Në 2015 ai u

përball me akuzën e shpërdorimit të detyrës, ndërimit të paligjshëm dhe falsifikim të dokumenteve, por në fund fitoi pafajësinë.

HETIMET

Nga hetimet e kryera nga prokuroria ka rezultuar se në kohën kur drejtonte bashkinë, Shpëtim Gjika i ka dhënë me koncesion, në kundërshtim me ligjin, një firmë amerikane që të administrojë parkingjet për 24 rrugë të qytetit bregdetar. Hetuesit kanë dyshime se firma koncesionare që ka fituar të drejtën për të menaxhuar për 15 vite parkingjet në Vlorë është favorizuar nga ish-kryebashkiaku. Gjithashtu, nga hetimet ka rezultuar se firma ka parashikuar që në rast të prishjes së kontratës, bashkia ka detyrim që t'i paguajë 20 milionë dollarë edhe pse investimet në terren kanë qenë shumë herë më të vogla.

Familjarët e torturuar kërkuar ndihmë te 112

Dhunonte bashkëshorten dhe fëmijët, arrestohet inspektori i Zjarrfikëses

TIRANË - Një telefonatë ka shpëtuar nga dhuna e vazhdueshme bashkëshorten e një zjarrfikësi dhe fëmijët. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme ka arrestuar një inspektor të Zjarrfikëses për dhunë në familje. Sipas të dhënave zyrtare, SHÇBA arrestoi në flagrancë Inspektorin e PMN-ZSH në Tiranë, Lorenc Hatia, për veprat penale të "Torturës" dhe "Dhunës në familje". Arrestimi u krye pasi në mënyrë sistematike, ai dyshohet se ka ushtruar dhunë fizike e psikologjike ndaj bashkëshortes dhe fëmijëve. Familjarët lajmëruan në numrin e Emergjencave 112 për akte dhune dhe më pas inspektori u shoqërua dhe u arrestua nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA). Më-



Inspektori Lorenc Hatia

sohet se për të dëmtuarit janë lëshuar urdhrat e mbrojtjes. Materialet procedurale iu dërguan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për hetime të mëtejshme. Vetëm dy vjet më parë inspektori i zjarrfikësve u bë 'hero' pasi ishte një nga

punonjësit e zjarrfikësve që mori pjesë në shpëtimin e Bibliotekës Kombëtare që u përfshi nga flakët në 16 mars 2017. Madje dhe kreu i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj publikoi foton e tij dhe një falënderim të veçantë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,840,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 19 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shqyrtuar nga janari deri në tetor 2018

Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar; atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHIGMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTITI
Hysni Rihane	Stafanasi Mihaka			V			V	V	ZV	P
		Selim	Mihaka	X	X					
		Nazrije	Cenaj	X	X					
		Artan	Mihaka	X	X					
Hasije	Ruci			V						P
Shaban Rami	Feto					V	V	V		
		Genci	Feto	V	V	V	V	V		
		Valbona	Feto	V	V					
		Ferdinand	Feto	V	V					
Xhevat	Feto					V	X	X		
Dita	Mucka			V	V					
Myrvet	Feto					V	X	X		
Nashije	Ndreu			V						P
Engjell	Ndreu			V	V					V
Englantina	Zylli			V						P
Anila	Lamaj			V						P
rezi (Rezeargjend)	Ndreu			V						P V
Maria	Shtrepi					V	V	V		
Spiro	Shtrepi			V	V	V	V	V		
Dhimitri	Shtrepi			V	V					
Haxhije	Cipi					V	V	V		
Haxhije	Cipi			V	V					
Drita	Cipi			V	V					
Martin	Gjonkollaj					V	V	V	ZV	V
		Dodë	Gjonkollaj	V	V					
		Lekë	Gjonkollaj			V	V	V		P
		Ndau	Gjonkollaj	V						P
		Lulë	Murkaj	V						P
						V	V	V		
Belije	Mullaku			V	V					
Leopolda	Muja					V	V	V		
Tomorr	Muja			V	X	V	V	V		
Shpetin	Muja			V	V	V	V	V		
		Rigela	Muja	V	V					
Hajdar	Dalpi					V	V	V		V
		Ilirjan	Dalpi	V	V					V1
		Monika	Dalpi	V						P1
		Dalpi	Dosti	V						P1
Hysnaje	Levenshti					V	V	V		P
		Qemal	Levenshti	V						
Engjell	Dosti					V	V	V		V
		Alfons	Dosti	V	V					P
		Ferdie	Peti	V						P
Hasiz	Mjekra					V VGJ	V neg	V		
		Balfjar	Mjekra	V	V	V	V	V		
		Shpresa	Tufi	V	V					
		Merila	Hoshu	V	V					
		Drita	Hoshu	V	V					
		Enzim	Mjekra	V	V					
Florenca	Soko					V	V	V		
Abina	Bushati			V	V			X	X	
Gjorgjeta	Kabashi			V	V					
Nikolin (Kole)	Destarisha			V	V					V

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHIGMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTITI
Seferdin	Dosti					V	V	V		
		Ylli	Dosti	V	V					
Halim	Dosti					V	V	V		
		Aleko	Dosti	V						P
		Nesli	Dosti	V						P
		Njazi	Dosti	V	V					P
		Seja	Dosti	V						P
		Islam	Dosti	V						P
		Ridvan	Dosti	V	V					P
		Skender	Dosti	V	V					
		Qesnor	Dosti	V	X					
Vangjel	Coka					V	V	V		
Aferdita	Ramu					V	V	V		
		Jari	Ramu	V	X					
		Romeo	Ramu	V	V					
		Vasken	Ramu	V	X					
Aleksander	Coka					V	V	V		
		Arben	Coka	V	V					V
		Theo (Teodor)	Coka	V						P
Sotir	Coka					V	V	V		
		Erton	Coka	V	X					
		Rebeka	Parisot	V	X					
		Tedi	Coka	V	X					
Gerardina	Mihali					V	V	V		
						V	V	V		
						V	V	V		
Lume	Agolli					V	V	V		
Nijas	Agolli			V	V					
Nanit	Agolli			V	V					
Zenit	Agolli					V	V	X		
Reshah	Agolli					V	V	V		
Qerim	Agolli	Bardhyl	Agolli	V	V	X	X			
Valk	Lita					V	V	V		
Vehap	Lita					V	V	V		
Hanife	Elezi					V	V	V		
		Melha	Elezi	V	V					
		Fidajete	Krasniqi	V	V					
		Reshat	Elezaj	V	V					
		Tasim	Elezaj	V	V					
		Resrije	Soko	V	V					
		Mevhude	Puci	V	V					
		Vahide	Bresa	V	V					
		Teki	Elezi	V	V					
Sherif	Lita					V	V	ZV		
		Man	Lita	V	V					
Shukrie	Ndreu					V	V	V		
		Avni	Ndreu			V				
		Narushe	Elezi	V	V					
		Nezir	Ndreu	V	V					
Valk	Lita					V	V	V		
Rzalim	Lita					V	V	V		
Vehap	Lita					V	V	V		
Hanife	Elezi					V	V	V		
		Melha	Elezi	V	V					
		Fidajete	Krasniqi	V	V					
		Reshat	Elezaj	V	V					
		Tasim	Elezaj	V	V					
		Resrije	Soko	V	V					
		Mevhude	Puci	V	V					
		Vahide	Bresa	V	V					
		Teki	Elezi	V	V					
Sherif	Lita					V	V	ZV		
		Man	Lita	V	V					
Shukrie	Ndreu	Avni	Ndreu			V	V	V		

Skadon afati ligjor, Baçi-pronarëve: Filloni procedurat në Gjykatën e Shkallës së Parë

ATP çon në gjykatë për vlerësim 6 950 dosje pronash

Nga 16 462 kërkesa për kompensim, morën përgjigje 9 512

Agjencia e Trajtit të Pronave mbyll procesin e vlerësimit financiar të dosjeve të ish-pronarëve, por pa mundur të përfundojë procesin për 6 950 dosje. Me anë të një njoftimi ATP u kërkon pronarëve t'i drejtohen gjykatës për të marrë vlerësimin dhe kompensimin e pronave, pasi prej tre vjetësh nuk ka mundur të përfundojë shqyrtimin e tyre. ATP kishte marrë përsipër të kryente vlerësimin për 16 462 pronave brenda tre viteve, por ky afat skadoi dje, në 23 shkurt. Pronarët që presin të marrin kompensimin për pronën kanë aplikuar që në vitin 2015, por deri tani jo vetëm që nuk kanë marrë kompensimin, por as nuk janë njohur ende me vlerësimin financiar. "Sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit, afati i vlerësimit të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën për kompensim nga ana e Agjencisë së Trajtit të Pronave përfundon në datën 23.02.2019. Sa më sipër, Agjencia e Trajtit të Pronave, me anë të këtij njoftimi informon subjektet e interesuara përmbylljen e procesit të vlerësimit financiar të vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Gjithashtu, Agjencia e Trajtit të Pronave është e gatshme dhe për çdo informacion apo paqartësi, ju fton të paraqiteni pranë sporteleve të institucionit"-thuhet në njoftimin e botuar dje në faqen zyrtare të ATP-së. Gjithashtu ATP bën me dije se procesi i ndarjes së Fondit të Kompensimit të Pronave vazhdon deri në kompensimin, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të të gjitha subjekteve që disponojnë vendim përfundimtar kompensimi dhe brenda afatit të përcaktuar.



Jonida Baçi, kreu i ATP-së

PROCEDURAT

Të gjithë subjektet aplikues (trashëgimtar ligjor/përfaqësues me prokurë) do të njoftohen nga Agjencia e Trajtit të Pronave individualisht, të tërheqin dokumentacionin e deponuar pranë sporteleve të institucionit, në mënyrë që të fillojnë me procedurat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.



Shitblerja e automjeteve, ndryshojnë procedurat dhe tarifat

Personat që duan të ndryshojnë pronësinë e mjetit duhet të paraqiten pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor për të kryer procedurën. Tarifa e shërbimit është 1400 lekë. Rregullat e reja hyjnë në fuqi nga 1 marsi të këtij viti. 2019. Lajmin për shërbimin e ri e ka bërë të ditur kjo e fundit përmes një njoftimi zyrtar, ku tarifa e përcaktuar për këtë shërbim është 1400 lekë. "Tjetër lajm i mirë për qytetarët! Nga 1 marsi ndërrimi i pronësisë së mjetit direkt edhe në sportele tona. Tarifa e shërbimit vetëm 1400 lekë! Siguri për shitësin e blerësin, verifikim i plotë në sistem. Shërbimi më i ri e i shumëpritur nga qytetarët nis nga Tirana e do ofrohet në gjithë drejtoritë rajonale me cilësi e vëmendje brenda muajit Mars!"-thuhet në njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.

kurë) do të njoftohen nga Agjencia e Trajtit të Pronave individualisht, të tërheqin dokumentacionin e deponuar pranë sporteleve të institucionit, në mënyrë që të fillojnë me procedurat pranë gjykatës së shkallës së parë"-thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtit të Pronave, i cili mban firmën e kreut të këtij institucioni Jonida Baçi.

NJOFTIMI

"Pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave, kanë qenë për t'u shqyrtuar gjithsej 16.462 kërkesa të patrajtuara për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë, të cilat përfaqësojnë kërkesat për njohjen e së drejtës së pronës, të bëra para hyrjes në fuqi të ligjit 133/2015 si dhe kërkesat e bëra brenda afatit 90 ditor nga hyrja në fuqi e ligjit. Në

bazë të kompetencave që ligji i ka njohur, Agjencia e Trajtit të Pronave, gjatë periudhës 3 vjeçare, ka trajtuar 9 512 kërkesa, për njohjen e së drejtës së pronës"-thuhet në njoftim. "Procesi i shqyrtimit të dosjeve, që janë aplikuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në proces shqyrtimi pranë Agjencisë, përfundon brenda 3 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Procesi i ndarjes së Fondit të Kompensimit të pronave vazhdon deri në kompensimin, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të të gjitha subjekteve që disponojnë vendim përfundimtar kompensimi dhe brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, të nenit 16, të këtij ligji. Nëse ATP-ja nuk përmush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda

afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t'i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit, afati i shqyrtimit të kërkesave të patrajtuara nga ana e Agjencisë së Trajtit të Pronave përfundon më datën 23.02.2019"-thuhet në njoftimin e ATP-së.

Investimet në euro

Asetet e fondit të investimeve ranë me 30% në 2018



iardë eurove, 11% më shumë krahasuar me një vit më parë. Pavarësisht interesave praktikisht në zero, madje edhe një zhvlerësimi të

ndjeshëm të monedhës europiane kundrejt lekut, shqiptarët vazhdojnë t'i besojnë kryesisht euros si monedhë kursimi.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 20.03.2019 ora 8:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i llojtë për shirjen e pasurisë së paluajtshme. Apartamenti me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Cilirim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bartha Xhemal Xhafa me vlerë fillestare në ankand 22.727.6 (Njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail



Erërat e forta - ARRSH: Tabela të rrëzuara e dëmtime të sinjalistikës

Erërat e forta kanë shkaktuar incidente në shumë qytete të vendit. Përmes një njoftimi, Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se si pasojë e tyre ka pasur dëmtime dhe shembje të sinjalistikës rrugore në disa akse. "Si pasojë e erërave të forta në akset: Milot-Lezhë-Shkodër, Thumanë-Milot ka pasur disa tabela të rrëzuara dhe ka dëmtim të sinjalistikës vertikale. Gjithashtu, mbas Mamurrasit në drejtim të Lezhës vijon erë me intensitet të lartë."-thuhet në njoftimin e ARRSH. Ndërkohë, erëra të forta kanë përfshirë edhe Korçën e Gjirokastrën, ku ARRSH këshillon drejtuesit e mjeteve që të përdorin zinxhirë gjatë qarkullimit. Ndërsa, janë regjistruar incidente edhe në segmentin Tiranë-Elbasan. "Në segmentin Tiranë-Elbasan ka pasur rënie të një peme në trup të rrugës, grupi i punës është në vendndodhje dhe ka punuar për pastrimin e rrugës dhe rihapjen e qarkullimit",-thuhet më tej në njoftimin e ARRSH-së, e cila fton përdoruesit e mjeteve që të lëvizin me shpejtësi të reduktuar me qëllim shmangien e aksidenteve.

Arjan Leskaj dhe Hajredin Fratari kundërshtojnë vendimin e koncesionarit

Afera në Sharrë, ankohen ndërtuesit: Skandal! Pengon investitorët e huaj

"Në fund të fundit bie në kurriz të konsumatorëve"

Ndërtuesit vazhdojnë ta cilësojnë një vendim korruptiv, skandaloz dhe të padrejtë, vendimin për tarifën që duhet t'i paguajnë koncesionarit "Integrated Energy B. V" në landfillin e Sharrës për çdo ton dhe, që janë të detyruar të shkarkojnë në të. Ndërtuesi Arjan Leskaj thotë se përpara këtij vendimi të pashkruar, për dherat e shkarkuar në landfill, nuk paguhej një tarifë e tillë.

"Për mua është veprim i pastër korruptiv i pa negociuar me biznesin se çfarë janë mbetje dhe dhera. Për mua është një rast skandaloz. Sektori i ndërtimit është sektori më i ngarkuar me taksa. Përpara ka qenë pa taksë fare ndërsa tani po detyrohem nga inspektorati t'i çojmë në landfill dhe të paguaj takse landfillit një gjë që është e padrejtë" - shprehet Leskaj.

Duke denoncuar këtë taksë të fshehtë, ndërtuesi Hajredin Fratari shprehet se me këto mënyra po largohen nga vendi investitorët e huaj, të cilët duan të investojnë në Shqipëri, pasi çdo ditë e më shumë bizneseve të ndërtimit po iu ngarkohen taksa shesë.

"Janë taksa të fshehta dhe që shkojnë rreth 60 % dhe investitorët e huaj çuditën me



të gjithë këto taksa që kemi ne. Çdo investitor i huaj sa merr vesh për taksa largohen për në Maqedoni apo Mal të Zi. Landfilli po abuzon në vend të paguaj ai, paguajmë ne. Këto janë taksa absurde

që po vendosen. Unë ndërtoj dhe në Romë dhe habitem dhe nuk arrij ta kuptoj sesi të detyrojnë për dherat t'i çosh atje dhe të paguash dhe një taksë për të. Ndërtimet që bëjnë Romë më jepnin lek për

dherat që i çoja, sepse i nevojiteshin ato dhera private të tjerë për mbushje." - thekson Fratari. Kjo taksë për ndërtuesit është absurde dhe një shqetësim i madh pasi në fund kostot bien në kurriz

VENDIMI
Bashkia e Tiranës me anë të Policisë Bashkiake dhe Inspektoratit Mjedisor nuk i lejojnë kompanitë që të mund t'i depozitojnë mbetjet ndërtimore apo dherat në vende të tjera me një çmim më të ulët. Madje as të mund t'i shesin ato për llogari të kompanive të tjera që mund të kenë nevojë për dherat e përfutuara nga hapja e gropave të ndërtimit.

kostova artificiale. E gjitha kjo ka krijuar një situatë shumë shqetësuese për komplet shoqatën e ndërtuesve. Ne përditë kemi ankesa nga anëtarët e shoqatës", thotë Leskaj

Një situatë e paprecedent ndodh çdo ditë me kamionët në zonën e trajtimit të mbetjeve në Sharrë. Koncesionari "Integrated Energy B. V" ka shtuar masat e kontrolit të kamionëve.

Koncesionari i inceneratorit të zonës së trajtimit të mbetjeve në Sharrë ka kaktuar një tarifë 480 lekë/ton, për çdo mjet që shkarkon dhera apo mbetje ndërtimore, ndërkohë që merr nga bashkia 29 euro për çdo ton mbetje organike, të prodhuar nga banorët e krugëqytetit dhe zonave përreth. Situata monopol ka marrë miratimin e Bashkisë së krugëqytetit.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



KONFERENCA

BERND J. FISCHER:

Ikja e gjermanit të fundit? Data është vendim politik

Komunizmi mbetet ende prezent në të tashmen e Shqipërisë, por provat janë mjeti më i fortë që kanë sot historianët në duar për të sjellë një panoramë të qartë të Shqipërisë në ato vite". Kështu e nisi diskutimin e tij sot historiani Bernd J. Fischer në simpoziumin e organizuar nga IDMC mbi qasjen aktuale studimore ndaj komunizmit, i konceptuar si forum shkëmbimi përvojash e idesh. Fischer tregoi përpara të pranishmëve sfidat që sjell puna me dokumentet duke paraqitur detaje nga dy raporte ai gjerman dhe ai amerikan që kanë studiuar atë periudhë, të prodhuara nga ekspertë të huaj, përkatësisht raporti i Vermaht-it mbi Shqipërinë, dhe studimi i Jacobsonit. Sipas raportit 50 faqesh të Vermaht-it data e largimit të gjermanëve nga vendi ynë ka qenë 4 dhjetor 1944, por Fischer nuk u ndal gjatë në këtë pike, sepse sipas tij vendosja e datave historike për ngjarje të tilla ka qenë gjithmonë një vendim politik edhe në shtete të tjera. Raporti amerikan prej 250 faqesh ofronte informacione të ndryshme, ndër të tjera edhe për kushtet e burgjeve, proceseve gjyqësore etj. Kurse raporti gjerman sipas tij prekte shumë çështje të mprehta, ndër to edhe aspekte sociale siç ishte mungesa e aksesit ndaj shërbimit shëndetësor për 80 % të shqiptarëve.

Studiuesi Igor Duda, përfaqësues i një qendre kërkimore për studime kulturore dhe historike mbi socializmin solli përvojën kroate, përmes projektit "Njeriu i Ri" socialist. Studimi i tij ishte shtrirë në disa fusha si histori, etnografi, antropologji, muzikologji etj., dhe i referohej një periudhe 20 vjeçare studimore. Përmes prezantimit të Igor Dudas pjesëmarrësit mundën të shihnin sa hapa përpara ka bërë Kroacia në mbështetjen që i jep studimeve mbi socializmin gjatë periudhës së Titos, krahasuar me Shqipërinë ku studimet shumë pak financohen dhe mbështeten.

Përfaqësues nga institucionet shqiptare studimore e pasuruan simpoziumin me përvojën e tyre. Agron Tufa, përfaqësues i ISKK, ngriti problemin e aksesit në arkivat e SHISH dhe të ish-Sigurimit, që kanë qenë dikur pjesë e Ministrisë së Brendshme, por tani i kanë kaluar Autoritetit. Ndërsa drejtori i Arkivit Shtetëror, Arditi Bido, foli për deklasifikimin e mijëra dokumenteve së fundmi, ndër to edhe deklasifikimin e fondit personal të Enver Hoxhës dhe Hysni Kapos. Bido u shpreh se



Historiani: Komunizmi mbetet ende prezent në të tashmen e Shqipërisë

tani mund të konsultohen shumë dokumente me vlerë për të nxjerrë në pah historinë reale të asaj kohe. Por sipas tij, pengesë vazhdon të ishte mentaliteti apo një lloj frike nga punonjësit e arkivës, të cilët nuk dinë të sillen kur u qëllon t'u bien në duar informacione të rëndësishme, sepse druajnë se prekin ndonjë sekret shtetëror.

Ish-drejtorja e Arkivit të Shtetit, Nevila Nika solli shembuj konkretë nga përvoja e saj gjatë 37 viteve punë në arkiva. Ndër të tjera ajo u shpreh e indinjuar për largimin nga puna të mbi 50 punonjësve të arkivit në vitin 2015, duke e dëmtuar rëndë punën e institucionit.

Ndërsa historiani Marenglen Kasmi nga AIDSSH sqaroi në fjalën tij se përpunimi i kërkesave për konsultim të dosjeve ishte delikat dhe kërkonte më shumë kohë. AIDSSH sipas tij ishte i hapur për të ofruar materiale dhe dokumente, por procedurat zgjatan jo vetëm në Shqipëri, sepse kriteret e përpunimit të informacionit ishin përcaktuara në ligj. Madje Kasmi u shpreh se pika të ndryshme të ligjit të dosjeve mund të amendoheshin në të ardhmen.

Studiuesja dhe historiania Sonila Boçi prezantoi projektin shkencor të profilit të intelektualit dhe shkencëtarit në periudhën 1944-1954. Kurse antropologu Albert P.Nikolla u fokusua te dy studimet e tij, njëri mbi "Njeriu në

Ri" shqiptar dhe tjetri mbi lëvizjen e '68-ës në Shqipëri.

Përveç studimeve të fushës në sallë ishin të pranishëm shumë ish-të përndjekur politikë, të cilët i përballën historianët me fakte konkrete nga përvoja e tyre në



burgje apo vende internimi dhe kërkuan "zgjidhje" historike. Aktivitetin e ndoqën edhe përfaqësues të trupit diplomatik, ambasadori polak, ambasadori austriak dhe përfaqësues nga ambasada kroate në Tiranë si dhe gazetarë.

Dje u prezantua edhe Manuali për Historinë Gojore si dhe ekspozita "Postcards from the Past".

Manuali i Historisë Gojore synon të inkurajojë mësuesit e shkollave të mesme, nxënësit dhe studiuesit e rinj që të mësojnë më shumë rreth historisë gojore dhe procesit të intervistimit. Manuali paraqet mjetet e nevojshme për t'i përfshirë

këto intervista në detyrat dhe projektet kërkimore në shkollat e mesme. Për të arritur këto objektiva, materiali është organizuar në mënyrë të tillë, ku disa kapituj trajtojnë zhvillimin e historisë gojore dhe metodave të intervistimit, nga fillesat e saj dhe deri të përcaktimit bashkëkohor. Aktiviteti do të shoqërohet me shembuj konkretë sesi është përdorur nga të rinjtë historia gojore në projektin kreativ "Pyet gjyshërit". Eventi do të mbyllet me prezantimin e ekspozitës së IDMC që paraqet në mënyrë ironike jetën e përditshme në diktaturë.

(REFLEKSION)

Thoma Note

Nuk bëhet fjalë për përqindjen e shpërndarjes së aksioneve të ndonjë shoqërie aksionere. E kam fjalën për koncertin e fundit të orkestrës simfonike të radiotelevizionit shqiptar.

Nuk e ndjej veten të aftë të përshkruaj apo të shpjegoj mrekullinë që u krijua në sallën e Akademisë së Arteve në Tiranë, ditën e premte më 22 shkurt 2019, nga interpretimi i orkestrës simfonike të Radio-Televizionit Shqiptar, nën drejtimin e dirigjentit të ri amerikan Gregory Charette apo magjinë e tingujve të violinistit virtuoz holandez Joseph Puglia, ku me mjeshtëri të rrallë u interpretuan Peer Gynt - Suite No.1, Op.46 nga Edvard Grieg, Concert për violinë, Op.14 nga Samuel Barber

50 me 50

dhe Suitë për orkestër nga Aaron Copland.

Do të desha të ndalesha te një detaj, në dukje krejt rastësor dhe i parëndësishëm, por që në këndvështrimin tim përmban një domethenie të madhe: Orkestra përbëhej nga pesëdhjetë instrumentistë; po aq ishte edhe numri i dëgjuesve në sallë.

Nuk di pse, nën efektin e magjisë së tingujve, mu kujtua interpretimi orkestrës së vogël te filmi "Titaniku" gjatë kohës që njerëzit, të çoroditur nga katastrofa që po ndodhte, mundoheshin të shpëtonin ekzistencën. Mu kujtua gjithashtu se dikur salla e Institutit të Arteve (Atëbotë ajo nuk kishte emrin e shquar "Akademi") mbushej plot e nuk gjeje dot bileta edhe për koncerte shumë më

modeste se niveli i koncertit të tanishëm. Dhe ndjeva keqardhje. E, vetvetiu më lindën shumë pikëpyetje: Pse?

Drejt çfarë kullote apo humnere po e drejtojnë "barinjët" shoqërinë shqiptare? Drejt një shoqërie perëndimore moderne, siç aspironte në hapat e para të krijimit të sistemit politik shumë-partiak apo drejt një lufte civile siç të lënë të kuptosh disa thirrje patetike të ndokujt, se populli ka të drejtë të rrëmbëjë armët, që "Ai" dhe shokët e tij të mos përfundojnë në burg!...

Edhe shoqëria njerëzore është si një orkestër simfonike, në të cilën çdo genie njerëzor është një vegël. Askush nuk është i parëndësishëm në këtë orkestër të madhe, sepse për të krijuar harmoninë universale duhet që secili për nesh të kryejë si duhet rolin e vet dhe të mbajë përgjegjësi për rolin që ka kryer.

E DIEL

24 Shkurt

2019

NGA PJETËR LOGORECI

Për teatrin gjermanisht folës, aktori Franz Eckhardt, ishte një ndër figurat e dashtuna e sidomos për publikun vjenez. Edhe pse kishte krye akademinë e arteve në Vjenë për art dramatik, ai ishte edhe këngëtar, skenarist, libretist, kabaretist e regjisor. Nana e tij, një aktore teatri, e la jetim në moshën 9 vjeçare, ndërsa i ati, që ishte drejtor teatri në Vjenë, u vra nga nazistët gjatë fushatave kundër hebrevjeve.

Fritzi u ngjiti në skenë si aktor ndihmës qysh në adoleshencën e tij, por karrierën e tij artistike, si profesionist, e filloi në moshën 24 vjeçare, si aktor i Teatrit Popullor të Vjenës përkrah aktorëve ma në za të kohës. Ai ishte multitalent. Përveç aktorit ai shkruante pjesë të shkurta komedie apo muzikë, por i detyruem të mbetej si autor anonim nga frika e përndjekjes si çifut nga nazistët. Gjatë karrierës së tij shumë vjeçare, ai u nderue me urdhënat dhe çmimet ma të nalta për një artist, në teatër, film, si libretist e kabaretist.

Si autor ai shkroi disa libra ndër të cilët edhe një libër biografik me titullin "Një aktor duhet të jetë i gjithëanshëm", ku përshkruhet jeta e karriera e tij dhe përfshirja e tij në fushën e teatrit, muzikës, filmit por edhe kujtime e anektda që i ndodhen në jetë dhe në skenë, ku përfshihen, aktorë e personalitete të famshëm.

Një ndër figurat e dashtuna dhe të respektueme për Fritzin ishte edhe aktori me origjinë shqiptare, gjeniu i skenës botnore Aleksander Moisi. Nëpërmes këtij shkrimi, dëshiroj me sjell për lexuesin shqiptar disa ndodhi apo anektda që Fritz Eckhardt përjetoi me Aleksandrin tonë.

Takimi i aktorit vjenez Fritz Eckhardt me gjeniuin e skenës Aleksander Moisiun.

Fritzi tregon: "Ma në fund më erdhi mundësia që të kem një rol, por një rol të vërtetë, në dramën e Gerhart Hauptmann "Shpëtimtari i Bardhë", që ishte në repertorin vijtor të Teatrit Popullor të Vjenës. Kjo dramë ishte zgjedhur nga drejtuesit e teatrit vetëm për shkakun se roli kryesor, ai i mbretit të Aztekëve, Montezumës, një rol që erdhi në këtë teatër si shkollë e plastikës,

MILOSA O



ALEKSANDER MOISI

Në kujtimet e aktorit austriak Fritz Eckhardt

interpretohej nga Aleksander Moisiu, që ishte ylli e ma i njohuni i ditës.

Vetëm mendimi se do të ndodhesha në skenë përballë gj-

gandit Aleksander Moisiu, se do ta kem partner, ishte emocioni më i madh në jetën time të sapo fillueme teatore. Në të vërtetë roli im ishte vetëm një frazë, por një frazë në

vargje dhe tepër e gjatë. Siç ishte zakon të "trajtoheshin" asokohe aktorët e rij, një ditë para premierës, një asistent i regjisorit u muer pak çaste me mue, tuj më "më-

sue" që batuten ta thojshë me ton të naltë, gati si ulurimë.

→ Vijnë në faqen 17

Basorelievi i Skënderbeut në fasadën e "Godinës së Artë" në Gdansk të Polonisë

NGA LEONARD ZISSI

Në këtë numër: XHEVAHIR SPAHIU, RAAMI SARI INTERVISTUAR NGA DR. JORINA KRYEZIU, PETRAQ RISTO, LEONARD ZISSI, PJETËR LOGORECI, BASHKIM HOXHA, QERIM VRIONI, ANDI PAPANSTEFANI, ETJ

D

DOKUMENT

"Në portin verior të Europës, në qytetin Gdansk të Polonisë, ndodhet një vepër tjetër e veçantë për llojin e saj. Gjergji [Skënderbeu] këtu është gdhendur në reliev. Midis gjithë veprave më të hershme, kjo është e vetmja e këtij lloji nga sa njohim deri tani". Përfshirja e basorelievit të Skënderbeut ndër 30 statujat, bustet dhe basorelievet e personaliteteve më të shquara në fasadën e Godinës së Artë në Gdansk, merr edhe një rëndësi tjetër të veçantë, sepse kjo Godinë, me një numur kaq të madh vepra arti, është nga më të rrallat dhe ndoshta e vetmja në Botë që ka një profil të tillë.

Basorelievi i Skënderbeut në fasadën e "Godinës së Artë" në Gdansk të Polonisë

NGA LEONARD ZISSI

Në sheshin qëndor të qytetit port më të madh të Polonisë, Gdansk, të quajtur "Tregu i Gjatë", ("D?ugi Targ") ndodhet një godinë nga më të bukurat, që quhet "Godina e Artë" (Fig. 1). Simbas studimit të master Jacek Bielak, dhuruar nga Konservatori i Qarkut të Gdanskut dr. Marian Kwapi?ski, rezultojnë se viti i fillimit të ndërtimit të kësaj Godine është viti 1609, ndërsa viti i përfundimit të ndërtimeve është viti 1617. Deri në vitin 1945, viti 1609 ka qënë vendosur në një glob që ndodhej poshtë këmbës së statujës së Perëndeshës së Fatit "FATUM", të vendosur në majën e kulmit të çatisë së Godinës. Pas shkatërrimit të kësaj Godine në vitin 1945, gjatë bombardimeve të Ushtrisë së Kuqe, në kuadër të luftimeve të Luftës II Botërore, pas rikonstruksionit të saj në vitin 1952, viti 1609 nuk është vendosur më në këtë Godinë. Ndërtuesi i saj ishte Kryetari i Bashkisë së Gdanskut të asaj kohe, Jan Speyman, një jurist gjerman dhe kolecionist i veprave të artit. Godina ishte projektuar nga arkitekti Abraham van den Blocke.

Gjatë katër shekujve të egzistencës së saj, kjo Godinë ka pësuar dëmtime të shumta ku më të rëndat kanë qënë ato të vitit 1813, gjatë marshimit të reparteve ushtarake të Napoelon Bonapartit drejt Moskës dhe ato të vitit 1945, kur Godina u shkatërua plotësisht nga bombardimet e Ushtrisë së Kuqe të B.Sovjetik. Sot Godina është pronë e Institutit të Detarisë të Polonisë dhe, përveç zyrave të tij, aty është vendosur edhe biblioteka e Jan Speymanit dhe një Galeri Arti.

Nga ana e jashtme e fasadës, Godina duket se është katër katëshe, por në brendësi ajo ka pesë kate (Fig. 1).

Në fasadën e Godinës së Artë, në katër kullonat e çdo kati si dhe në hapësirat midis kullonave, janë vendosur 30 skulptura, buste dhe basorelieve të personaliteteve nga më të shquarat të historisë së njerëzimit, nga lashtësia e deri në shekullin XVI. Përzgjedhja e tyre është ndarë në katër grupe: në personalitetet që kanë atributet e virtyteve të Zgjuarsisë, Drejtësisë, Mëshirës dhe Maturisë. Ato personifikohen me simbole kafshësh dhe konkretisht: Zgjuarësia me simbolin e kaprollit dhe brririt, Drejtësia me simbolin e luanit dhe



Fig. 3. Kupa e "Godinës së Artë" në Gdansk. Në majë skulptura e Perëndeshës së Fatit-Fatum, poshtë këmbës së saj viti 1609 i fillimit të ndërtimit të Godinës; në rreshtin e parë skulpturat e Kleopatërës, Edipit, Akilit dhe Antigones; në rreshtin e fundit busti i Solonit, basorelievi i Themistokliut, busti i Cato-s senior, basorelievi i Skënderbeut me Hunniadin, busti i Scipion-it junior, basorelievi i Scoevala-s dhe busti i Regulus Marcus Attilius.

librit, Mëshira me simbolin e dashit dhe kokës njerëzore dhe Maturia me simbolin e demit dhe kokës së qenit.

Mbështetur në këto kriterë, përzgjedhja e personaliteteve është bërë si më poshtë: në majë të Godinës është vendosur statuja e Perëndisë së Fatit-Fatum; në rreshtin 2 janë vendosur, nga e majta në të djathtë statujat e Kleopatras, Edipi-t, Akili-t dhe Antigona-s; në rreshtin 3 janë vendosur bustet e Kanton-it, Scypion-it, Kato Juniorit dhe Solon-it; në rreshtin katër janë vendosur simbolet e virtyteve të Zgjuarsisë, Drejtësisë, Heroizmit dhe Burrësisë, si dhe Maturisë. Statujat, bustet dhe basorelievet paraqiten në figurat 2, 3, 4 dhe 5.

Në rreshtin 5, sipër katit 3 të Godinës, janë vendosur bustet dhe basorelievet e mëposhtëm.

I.BUSTET NË "GODINËN E ARTË"

1. Në kullonën e parë vertikale, nga e majta, rreshti 5, atributi i Zgjuarsisë, duke filluar nga lart poshtë, janë vendosur bustet e:

- Në katin e tretë, busti i Solonit (635-560 p.e.s.). Përcaktohet si një ndër 7 njerëzit më të mençur të lashtësisë. Burrë shteti dhe politikan. Ka luajtur rol të rëndësishëm



Fig. 5. Fragment i bustit të Skënderbeut në basorelievin e "Godinës së Artë" në Gdansk.

në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis athinasve.

2. Në katin e dytë busti i Kato Junior (Marcuc Porcius Cato Utinensis - 95-46 p.e.s.). Personalitete i shquar, duke u mbiquajtur i Mrekullueshmi.

2. Në kullonën e dytë vertikale, nga e majta, rreshti 5, atributi i Drejtësisë, duke filluar nga lart poshtë, janë vendosur bustet e:

- Në katin e tretë busti i Cato Senior Cenzor (Marcus Porcius



Fig. 4. Basorelievi i Skënderbeut dhe Hunniad-it në fasadën e "Godinës së Artë" në Gdansk

Cato Maior Censorius - rreth viteve 234-149 p.e.s.) Personalitet i shquar i mbrojtjes së Republikës Romake, i pakorruptuar, armik i tiranisë, vendosi për herë të parë në Romë taksën mbi pronën, themelues i prozës letare latine.

- Në katin e dytë busti i Otto III - perandor gjerman. Në historiografi njihet si pushtetar që përfaqësonte jo vetëm interesat e Gjermanisë, por edhe për vendosjen e rrendit dhe qetësisë në Europë.

- Në katin e parë busti i Zigmunt III Waza - 1566-1632. Mbret polak. Furnizoi Italinë me drithra në periudhën e urisë së saj. Në vitin 1612 pushtoi Moskën.

3. Në kullonën e tretë vertikale, nga e majta, rreshti 5, atributi i Burrërisë, duke filluar nga lart poshtë, janë vendosur bustet e:

- Në katin e tretë busti i Scipion Junior Afrikanasi-t (Publius Cornelius Aemilianus Afrikanus Minor, Numantus - 185-129 p.e.s.). Ishte djalë i adoptuar i Scipion Seniorit. Komandant i shquar ushtarak që në vitin 146 p.e.s. pushtoi Kartagenën gjatë luftës III punike.

- Në katin e dytë busti i Villadisslav Jagiello-s -1351-1434. Mbret i Polonisë dhe Princi i Madh i Lituanisë, që në ato vite ishin shtete në Union me njeri tjetrin. Në vitin 1410 mundi Kalorësit Teutonë në betejën e famshme të Grundvaldit.

- Në katin e parë busti i Henrik-rikut IV - 1533-1610. Themelues i dinastisë së shquar franceze të Bourbonëve. Realizoi një numur të madh fitoresh ndaj katolikëve, gjatë luftës fetare në Francë.

4. Në kollonën e katërt vertikale, nga e majta, rreshti 5, atributi i Maturisë, duke filluar nga lart poshtë, janë vendosur bustet e:

- Në katin e tretë busti i Regulus Marcus Attilius - Komandant i shquar gjatë luftës së parë Punike. U zu rob nga kartagjenasit, por u lirua prej tyre, me qëllim që të bindëte pushtetarët e Romës që të hiqnin dorë nga lufta kundër Kartagjenës, por ai veprroi në të kundërt duke inspiruar Romën për vazhdimin e luftimeve. Pasi u kthye në Kartagjenë, u burgos dhe vdiq nga torturat.

- Në katin e dytë busti i Caius Fabricius Lusinus - jetuar midis shekujve IV/III p.e.s.

Udhëheqës Romak që shquhej për ndershmëri dhe ruajtjes me rigorozitet të traditave romake. Gjatë luftës së Romës me Pirron e Epirit në vitin 282 p.e.s. u dërgua në kampin e Pirros për të biseduar lidhur me shkëmbimin e robërve. Pirroja u përpoq ta blinte Fabricius-in me arka me flori dhe gurë të çmuar. Kur kjo nuk dha rezultat, u përpoq ta trembë, duke i dërguar në çadër një elefanta të madh për ta shtypur. Të dy këto përpjekje nuk dhanë rezultat. Në vitin 278 Fabriciusi i dërgoi Pirros mjekun e tij, i cili në shkëmbin të një shpërblymimi të madh në para,

pranoi ta helmonte atë. Por, duke parë fisnikërinë e Fabriciusit, Pirroja u detyrua të tërhiqet nga Italia.

- Në katin e parë busti i Scipio Senjor (Publius Cornelius Scipio Africanus Maior) Jetuar në periudhën 236-184 p.e.s. Ka qenë një komandant i shkëlqyer ushtarak i luftës II Punike, shpartalluesi i Hazdrub-it në Spanjë dhe Hanibalit në fushë-betejën e Zamës në Afrikë. Prej kësaj ka marrë edhe nofkën Afrikani.

BASORELIEVET NË "GODINËN E ARTË"

1. Në hapësirën midis kollonave alegorike të Zgjuarsisë dhe Drejtësisë nga lart poshtë janë vendosur basorelievet e:

- Në katin e tretë, basorelievi i Themistokli-ut. Jetoj rreth viteve 524-459. Politikani dhe burrë shteti i Greqisë së lashtë. Porcoi shumë flotën greke tregtare dhe atë ushtarake, e cila luajti një rol të rëndësishëm në shpartallimin e ushtrive Perse të Kserksit në vitin 480 p.e.s. në afërsi të Salaminës. Të lashtët e vlerësonin si simbol i virtyeteve njerëzore.

- Në katin e dytë, basorelievi i Lucius Junius Brutus - 85-42 p.e.s. Basorelievi përbehet nga dy skema. Në njerën paraqitet vdekja e Lukrecje-s dhe betimi i Bruti-t për tu hakmarur kundër perandorit Tarkvinus. Për këtë vlerësohet si themelues i Republikës dhe hero i vendosjes së Drejtësisë në emër të të varfërve. Skema e dytë paraqet castin kur Bruti i jep goditje vdekjeprurëse Jul Cezarit më 15.III.44 p.e.s.

- Në katin e parë, basorelievi i hebreut Maccabeus-it, bir i Matatias, vdekur në vitin 160 p.e.s. Udhëhoqi kryengritjen e hebrejeve kundër dinastisë të Seleucidëve, për të përfshirë kultet pagane në faktoret e Jerolimës. Duke fituar kryengritjen, ktheu kultin e Jehovait.

2. Në hapësirën midis kollonave alegorike të Drejtësisë dhe Burrërisë nga lart poshtë janë vendosur basorelievet e:

- Në katin e tretë basorelievi



Fig. 1. Fasada e "Godinës së Artë" në Gdansk

i Skënderbeut me Hunniadin. Basorelievi paraqet dy kalorës autentikë, Gjergj Kastriot Skënderbeun dhe Janosh Hunniadi-n. Në sfond paraqitet kalorësia turke duke u tërhequr në formë gjysmë rrethi, që ishte karakteristike e betejave të saj. Ajo përdorte një taktikë specifike gjatë luftimeve, bënte sikur tërhiqej nga luftimi dhe pastaj, papritur rikthehej në fushën e betejës, duke shpartalluar repartet e lodhura të ushtrive armike. Dhe heronjtë në kuaj janë luftëtarë të shquar në betejat kundër hordive turke: Skënderbeu (1405-1469), princi shqiptar, i cili për shumë vjet zbrapsi me sukses sulmet e ushtrive turke dhe Janosh Haunniadi (1385-1456) vojevoda e Siedmoigrodit, që mori pjesë në betejën e Varnës në vitin 1444, bashkë me mbretin polak Vladislav III, që e humbën këtë betejë, por pastaj Hunniadi fitoi mbi ushtritë turke në afërsi të Beogradit. Sukseset e tij zbrapsën për një farë kohe kërcënimin turk.

- Në katin e dytë, basorelievi me dy mburoja të Johan Speyman von der Speie me stema secila. Njera përmban stemën e fondatorit dhe pronarit të Godinës së Artë, Johan Speyman-it dhe tjetra stemën e gruas së tij Judita nga fisi Bahrov.

- Në katin e parë basorelievi i Horatius Cocles (Publius Horatius Cocles). Komandant trim ushtarak Romak. Simbas legjendës, në luftimet me ushtritë e Porsennit,

4 pushtetar i fisit etrusk Clusium, bashkë me dy shokë të tjerë ndaluan në një urë dhe u përpoqën të

kalonin në bregun tjetër të lumit që mbrohej nga vetë Cocles-i. U përpoq të shkatëronte urën me sopata, për të mos lejuar kalimin e ushtrive armike. Basorelievi paraqet castin kur Horatius-i, bashkë me dy shokë të tjerë, hidhet nga ura në lumë dhe mbyten.

3. Në hapësirën midis kollonave alegorike të Burrërisë dhe Maturisë nga lart poshtë janë vendosur basorelievet e:

- Në katin e tretë basorelievi i Scaevola-s (Caius Mucius Scaevola). Hero Romak i luftës me Porsennin në vitin 508 p.e.s. Gjatë luftimeve u kap rob, duke u përpiqur të vrasë mbretin armik. Në kohën kur do t'i digjnin krahun e djathtë, deklaroi se nuk u trembet as torturave dhe as vdekjes dhe se, përveç tij, edhe 300

luftëtarë të tjerë do të përpiqen të vrasin mbretin. Porsenna u mahnit nga guximi dhe kurajoja e Scaevola-s, prandaj u tërhoq nga rrethimi i Romës, duke i falur Scaevola-s dënimin dhe filloi bisedimet e paqes me Romën.

- Në katin e dytë basorelievi i Horatit-t. Simbas legjendës, Horatit, bashkë me dy vëllezërit e tij, po luftonin me tre ushtarë të Kryqëzatave. Kur gjatë luftimeve u vranë dy vëllezërit e Horatit-t, ndërsa tre vëllezërit Kryqtarë nuk

leëshonin në fush-betejën ndonëse ishin të plagosur, Horatit bëri sikur u tërhoq nga luftimi dhe u kthye përsëri në fushë-betejë, duke i vranë tre vëllezërit Kryqtarë. Skema e basorelievit paraqet castin kur vritet vëllai i dytë i Horatit-t, ndërsa ai i plagosur bën gjestin mashtrues të




Figura 2. Skica e fasadës së "Godinës së Artë" në Gdansk (Poloni)

tërheqjes nga luftimi.

- Në katin e parë basorelievi i Camillus (Marcus Furius Camillus). Udhëheqës dhe politikan i shquar Romak. Mundi Galët që në vitin 340 p.e.s. kishin shkatëruar Romën. Pas kësaj filloi me rindërtimin e saj, duke u mbiquajtur "pater patriae" (at i atdheut), duke u bërë kështu themeluesi i dytë i Romës.

PORTALI

Portali është kati përdhës ose parteri i Godinës së Artë, kati i hyrjes në brendësi të saj. Në fasadën e këtij kati nuk ka buste, por basorelieve të ndryshme me simbole fetare. Ndryshe nga katet e tjerë ku statujat, bustet apo basorelievet shprehin virtytet kardinale, të pëgjithshme, që i përmendëm më sipër, tek portali dominojnë virtytet teologjike: Besimi, Shpresa dhe Dashuria.

Nga përshkrimi më lart i statujave, busteve dhe basorelievet që përmbahen në fasadën e "Godinës së Artë", rezultojn se, përveç basorelievit të Skënderbeut që është i lidhur drejtpërdrejt me historinë e Shqipërisë, është edhe busti i Caius Fabricius Lusinus-it që lidhet me lufrat e Pirros së Epirit në Itali në vitin 278 p.e.s. që u përmend më lart.

Vendosja e basorelievit të Skënderbeut në "Godinën e Artë" të Gdanskut lidhet me popullaritetin e madh që gëzonte figura e tij në Poloni. Lidhjet e para midis Shqipërisë dhe Polonisë datojnë që në vitin 1443, para betejës së Nishit, kur Skënderbeu është takuar

1. Statuja e Perëndeshës së Fati-t, Fatlum. Poshtë këmbës viti 1609, fillimi i ndërtimit të Godinës.

2. Statujat e Kleopatra-s, Edip-it, Akil-it dhe Antigona-s.

3. Bustet e Katon-it, Scypionit, Kato Junoir-it dhe Solon-it.

4. Simbolet me statuja kafshësh e virtyeteve: Zgjuarsisë, Drejtësisë, Heroizmit dhe Maturisë.

5. Busti i Solon-it, basorelievi i Themistokli-ut, busti i Cato-s, basorelievi i Skënderbeut dhe Hunniad-it, busti i Scipion Junior, basorelievi i Scaevola-s dhe busti i Regulus Marcus Attilius.

6. Simbolet pa statuja e atributeve të: Zgjuarsisë, Drejtësisë, Heroizmit dhe Maturisë.

7. Busti i Cato-s Junior, basorelievi i Brut-it, busti i Perandorit Otto, Stema e Johan Speyman-it, busti i mbretit polak Jagjello, basorelievi i Horatit-it dhe busti i Caius Fabricius Lusinus.

8. Busti i Medyceus-it (De'Medici), basorelievi i Maccabeus-it, busti i Sigismund-it III, basorelievi i Horatius Cocles-it, busti i Perandorit Henriccus, basorelievi i Camillus-it dhe busti i Scipionit-it.

9. Portali i "Godinës së Artë" me simbolet e virtyeteve teologjike të Mëshirës, Besimit dhe Shpresës.

5 fshehurazi në Budë me mbretin polak Vladislav III dhe me Janosh Hunniadin, mbreti regjent hungarez dhe vojevoda i Transilvanisë. Në ato vite Polonia me Hunnarinë bënin pjesë në një shtet të përbashkët dhe kishin formuar Unionin Polako-Hungarez. Simbas historiografisë polake, në vitin 1446 u vendosën marrëdhëniet e drejtpërdrejta diplomatike midis Shtetit Shqiptar të Skënderbeut dhe Mbretërisë Polake.

Basorelievi i Skënderbeut në fasadën e "Godinës së Artë" në Gdansk ka rëndësi të veçantë, sepse është i vetmi basoreliev për Heroin tonë Kombëtar që është gjetur deri tani i ekspozuar në Europë. Në shumë vende të ndryshme të Europës, në SHBA dhe në kontinente të tjerë janë shkruar shume vepra letrare, në poezi, prozë, dramaturgj, opera, etj. si dhe janë ngritur shumë monumente dhe buste, por basoreliev është gjetur vetëm një, ai i vendosur në fasadën e "Godinës së Artë" në Gdansk të Polonisë. Për këtë, studiuesi i mirënjohur Prof. Ferid Hudhri, në Enciklopedinë "Shqiptarët në Artin Botëror", faqe 379, shkruan:

"Në portin verior të Europës, në qytetin Gdansk të Polonisë, ndodhet një vepër tjetër e veçantë në llojin e saj. Gjergji [Skënderbeu] këtu është gdhendur në relief. Midis gjithë veprave më të hershme, kjo është e vetmja e këtij lloji nga sa njohim deri tani".

Përfshirja e basorelievit të Skënderbeut ndër 30 statujat, bustet dhe basorelievet e personaliteteve më të shquara në fasadën e Godinës së Artë në Gdansk, merr edhe një rëndësi tjetër të veçantë, sepse kjo Godinë, me një numur kaq të madh vepra arti, është nga më të rrallat dhe ndoshta e vetmja në Botë që ka një profil të tillë.

I

INTERVISTA

(MBI PËRKTËHIMET E RAMI SAARIT SHQIP-HEBRAISHT)

INTERVISTOI DHE REDAKTOI:
DR. JORINA KRYEZIU (SHKRETA)

Këtë intervistë do të doja ta nisja me një prezantim të shkurtër të punës suaj lidhur me përkthimin e autorëve shqiptarë në hebraisht, përkthim i cili është realizuar prej shqipes, ndryshe prej përkthyesve të tjerë, të cilët e kishin përkthyer letërsinë tonë prej frëngjishtes. Deri më sot, ju mbeteni përkthyesi i vetëm dhe më produktivi, që e keni sjellë letërsinë shqipe në hebraisht të përkthyer prej origjinalëve. Qysh prej vitit 1996 e në vijimësi, ju keni përkthyer dhe botuar poezi, prozë të shkurtër dhe romane të shkrimtarëve shqiptarë, si: Ismail Kadare, Ali Podrimja, Dritëro Agolli, Visar Zhiti, Lindita Arapi, Mira Meksi, Nasi Lera, Xhevahir Spahiu, Blendi Fevziu, Lindita Karadaku, Shaip Emërllahu, Betim Muço, Sabit Idrizi, Bashkim Canaj, Dhimitër Pojanaku, së fundmi edhe Luljeta Lleshanaku (më 2017-n) etj. Kjo punë e juaja, përveçse mundëson njohjen e letërsisë sonë përtej kontinentit evropian dhe në një gjuhë që letërsia shqipe rezulton e përkthyer në pak tituj, gjithashtu, mundëson përkthimin drejtpërdrejt prej shqipes, një përkthim adekuat, që i përmbahet dhe i përgjigjet origjinalit, si në përzgjedhjen e fjalëve ashtu edhe në ndërveprimin e rrafshëve gjuhësore.

Jorina Kryeziu: Si e mësuarat gjuhën shqipe, pra, si ratë në kontakt me të? Pse vendosët ta mësionit këtë gjuhë të veçantë e të largët gjeografikisht me ju? Cilat ishin planet tuaja për të?

Rami Saari: Gjithmonë isha i interesuar për të studiuar gjuhën shqipe, sepse në vendin tim nuk kishim mundësi për të dëgjuar për Shqipërinë, në radio ose në televizion, dhe shumë rrallë ka pasur lajme në lidhje me Shqipërinë nëpër gazeta. Por para vitit 1992, me pasaportën time, nuk kisha asnjë mundësi për të udhëtuar drejt Shqipërisë dhe për ta praktikuar atje gjuhën, prandaj u përqendrova në studimin e gjuhëve të tjera. Shqipërinë e kam vizituar për herë të parë në tetor të vitit 1992, por ishte një udhëtim shumë i shkurtër, që zgjati vetëm disa ditë, në Bilisht, në Korçë dhe në Pogradec. Më pas, më 1996, qendra në Tiranë, ndërroi në vitin 2006, përgjatë një jave, vizitova Pogradecin, Tiranën, Tetovën dhe Shkupin. Uroja që të mund të kaloja atje më shumë kohë, por për shkak të angazhimeve të mia nuk munda. Sa i takon mësimin të shqipes, fillova ta studioja atë në Universitetin Hebraik të Jerusalemit, në vitin 1995, nën mbikëqyrjen e dr. Nimrod Bari, një gjuhëtar izraelit që studioonte ballkanologji në Francë. Ai më mësoi

"...synimi im ishte të merrem në të ardhmen me përkthimin e letërsisë shqiptare në hebraisht, sepse te ne, fatkeqësisht, nuk kishte asgjë, përveç disa librave të Ismail Kadaresë, dhe të gjithë, tre ose katër prej tyre, deri në atë kohë ishin përkthyer prej frëngjishtes."

Dua ta përkthej letërsinë shqipe në hebraisht

Intervistë e Rami Saarit, përkthyesit të njohur hebre, që po mundohet të sjellë autorët shqiptarë në Izrael. Sfida dhe çfarë përball ai me këtë realitet, intervistuar nga studiuesja e njohur e letërsisë...



Përkthimet e mia

Parimet e mia nuk janë shkencore. Dëshiroj që përkthimi im të jetë sa më besnik, korrekt dhe i bukur, duke marrë parasysh veçantinë e tekstit original. Çdo autor është unik, secili tekst ka vështirësi të tij dhe, si përkthyes, detyra ime është që të mbështetem në atë që shkroi autori, pasi që unë i'a transmetoj atë lexuesve në gjuhën time, por nuk krijoi diçka që është krejtësisht imja, siç bëj kur shkruaj poezi të mia.

J. Kryeziu: Ju keni shkruar edhe artikuj për letërsinë shqipe në shtypin periodik izraelit. Cili është opinioni (qëndrimi) juaj për letërsinë shqipe? Ku u bazuat për të përzgjedhur poetët dhe prozatorët që keni përkthyer?

R. Saari: Siç ju thashë në përgjigjen time të mëparshme, kurë nuk kam pasur mundësi për të kaluar një periudhë më të gjatë në Shqipëri, për të mos përmendur për të studiuar letërsinë shqiptare në një universitet. Sidoqoftë, Na-

tasha dhe Veip Lushaj më treguan për autorët e tyre të parapëlqyer, më prezantuan të disa autorë dhe poetë përgjatë vizitës sime të dytë në Tiranë dhe më ndihmuam të kem e të njihem vazhdimisht me materiale nga Shqipëria. Vite më vonë kam pasur rastin të marr pjesë në festivalet poetike të Strugës dhe të Tetovës, ku takova disa poetë që shkruajnë shqip, për shembull: Shaip Emërllahu, Dhimitër Pojanaku, Artan Arslani dhe Ahmet Selmani. Kam njohur edhe disa shqiptarë që jetojnë dhe shk-

Njohja me lexuesin izraelit, përmes përkthimit të veprës së tij në hebraisht, trajtimi i temave universale dhe i lirisë së individit në shoqëri, i fali shkrimtarit Ismail Kadare çmimin "Jerusalem Prize 2015", në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Jerusalemin. Juria e këtij çmimi e vlerësoi shkrimtarin tonë për rrëfimin ironik e magjepsës, duke vënë në dukje se ai shkruan "për fajin kolektiv dhe natyrën e padepërtueshme të së vërtetës... Ai kërkoi të eksplorojë, duke u fshehur në shtresat e mitit dhe të metaforës." (SELA, Maya. "Ismail Kadare Named 2015 Jerusalem Prize Winner", në: "Ha-Aretz", më Jan 16, 2015).

qiptare përkthimi i letërsisë shqipe në hebraisht?

R. Saari: Për fat të keq nuk mund të jap ndonjë përgjigje të qartë për këtë pyetje. Shumë njerëz janë të interesuar për librat që unë përzgjedh për të përkthyer dhe ata ndjekin gjërat që unë përkthej, edhe kur përkthimet e mia janë tekste të shkurtra, tregime ose poezi. Megjithatë, përkthyesit në Izrael përballesh me shumë vështirësi, pasi nuk është gjithmonë e lehtë të bindësh shtëpitë botuese për të botuar literaturë belletres (Saari sqaron se e ka fjalën për librat joshkencorë, që kanë si qëllim të zgjerojnë horizontin e lexuesve), kur një ndihmesë ekonomike nga jashtë nuk është e përfshirë. Lexuesit për fat të mirë ende dëshirojnë të lexojnë më shumë libra të përkthyer, por bindja e një botuesi për t'u marrë me një libër, që ai ose ajo nuk mund ta lexojë, është një detyrë e vështirë. Kjo është e vërtetë jo vetëm për letërsinë shqipe, por edhe për librat që kam përkthyer nga disa gjuhë të tjera, që nuk njihen gjërësisht në Izrael, bë fjalë, libra të përkthyer nga finlandishtja, estonishtja, katalanishtja e, madje, greqishtja dhe turqishtja.

J. Kryeziu: C'mund të na thoni për rezultatet/impaktin që pati letërsia shqipe nga lexuesit izraelitë, si e pritën ata këtë letërsi thuajse të panjohur për ta?

R. Saari: Zakonisht me shumë interes dhe kuriozitet njihëresh, sepse kështu kishin, më në fund, një mundësi të jashtëzakonshme për të njohur diçka, që deri më atëherë ishte pothuajse tërësisht e panjohur. Disa njerëz e konsideronin veprimtarinë time në këtë fushë, të çuditshme, të pakuptueshme e, madje, bizarre ("të pazakontë"), por shumë të tjerë shfaqën interes dhe ishin të gëzuar, sepse ekspozoheshin ndaj një bote që e konsideronin magjike. Sidomos libri i Kadaresë Prill i thyer mori kritika pozitive dhe u bë shumë popullore midis lexuesve izraelitë.

J. Kryeziu: Si e shihni raportin mes rezultateve që ju prisnit prej lexuesve dhe rëndësisë që ka për letërsinë dhe kulturën sh-

J. Kryeziu: Ju keni përkthyer disa autorë shqiptarë, cila veprë, prozë e shkurtër apo poezi ju ka pëlqyer më së tepërmi? A mund të veçoni ndonjë mbresë gjatë përkthimeve të shkrimtarëve tanë?

R. Saari: Kadare: Prilli i thyer, Ura me tri harqe, Nënuesi i Palatit të Enderrave dhe shumë vepra të tjera të tij. Agolli: Njerëz të krisur. Meksi: Mall i shpirtrave. Zhiti: Këmba e Davidit. Lera: Ulërima e heshtur.

J. Kryeziu: A mendoni të botoni një përmbledhje antologjike poetike për këto përkthime? Apo do të qëndrojnë të përkthyer letërsinë në shtypin periodik izraelit?

R. Saari: Do të isha shumë i lumtur ta bëja këtë, por kjo nuk varet vetëm prej meje. Nuk mund të bëj asnjë lloj projekti të tillë pa një marrëveshje paraprake me një botues dhe, siç thashë, nuk është një detyrë e lehtë për të bindur botuesit që të ndërmarrin rrezik të tilla ekonomike, kur vlera letrare e librave nuk është e vetmja gjë që u intereson atyre...

J. Kryeziu: Cilat janë parimet, qoftë edhe shkencore, mbi të cilat bazoheni për të përkthyer? Cilat janë mundësitë që ju krijon e ofron gjuha shqipe gjatë procesit përkthimor? Po vështirësisë e saj ku konsistojnë?

R. Saari: Parimet e mia nuk janë shkencore. Dëshiroj që përkthimi im të jetë sa më besnik, korrekt dhe i bukur, duke marrë parasysh veçantinë e tekstit original. Çdo autor është unik, secili tekst ka vështirësitë e tij dhe, si përkthyes, detyra ime është që të mbështetem në atë që shkroi autori, pasi që unë t'ia transmetoj atë lexuesve në gjuhën time, por nuk krijoj diçka që është krejtësisht imja, siç bëj kur shkruaj poezitë e mia.

J. Kryeziu: Deri më tani keni përkthyer vetëm tri romane në shqip: "Prilli i thyer", "Piramida" dhe "Aksidenti", të gjitha vepra të shkrimtarit Ismail Kadare. Mbi ç'kritere i vendosni përzgjedhjet tuaja përkthimore?

R. Saari: Në të tria rastet librat u ofruan nga shtëpitë botuese izraelite, që i kanë lexuar këto romane në frëngjisht. I pranova t'i përktheja këta libra pasi i lexova në gjuhën shqipe dhe më pëlqyen. Reputacioni ndërkombëtar i Kadaresë me siguri ndihmoi vendimin e botuesve që të më luteshin t'i përktheja këto vepra.

J. Kryeziu: Idiolekti kadarean/gjuha tejet vetjake e tij mund t'jua ketë vështirësuar procesin përkthimor. A jeni konsultuar me përkthimë të tjera/gjuhë të tjera, për veprën e Kadaresë? Nëse po, në cilat konkretisht?

R. Saari: Në disa raste edhe jam ndalur të përkthimet e tjera të veprave të Kadaresë, por jo gjithmonë ka ndodhur kështu. Të tre librat (Prilli i thyer, Piramida dhe Aksidenti) ishin të disponueshëm në frëngjisht, por frëngjishtja është një gjuhë që nuk kam shfaqur asnjë interes për ta studiuar, kështu që kjo nuk më ndihmonte fare. Në thelb kam përdorur veç tekstin original të shqipes për përkthimin e librave, por në rastin e romanit Prilli i thyer kisha edhe përkthimin në gjuhën angleze, ndërsa në rastin e romanit Piramida kisha përkthimin në greqisht, si mjete ndihmëse dhe burime të krahasimit.

J. Kryeziu: Ismail Kadare është ndër ata shkrimtarë që krijojnë fjalë të reja/neologjizma, a përbën kjo për përkthyesin një vështirësi apo lehtësi, porë kjo në dy aspekte: së pari, në funksionin semantik të fjalës, së dyti, në përcjelljen e saj në gjuhën pritëse - duke e përkthyer po në trajtë neologjike apo duke e përkthyer të përafëruar me kuptimin që mbart?

R. Saari: Meqë kisha filluar të përktheja poezi, pothuajse një dekadë e gjysmë para fillimit të përkthimit të veprës së Kadaresë, nuk e konsiderova këtë si një problem. Ka gjithmonë shumë sfida në punën e një përkthyesi, por edhe neologjizmat mund të transmetohen në gjuhë të tjera, në qoftë se qëllimi original i autorit është i qartë.

J. Kryeziu: A do të përktheni sërish letërsi shqipe, nëse po, cilat janë projektet tuaja të së ardhmes?

R. Saari: Nëse do të më ofrojnë ta bëj dhe nëse më pëlqejnë librat që më ofrojnë, natyrisht, do ta bëj me kënaqësi. Do t'u sugjeroja edhe unë shtëpipe botuese libra të tjerë të letërsisë shqipe, që më kanë pëlqyer shumë, për shembull: Njerëz të krisur prej Dritëro Agolli dhe Këmba e Davidit prej Visar Zhitit, por meqenëse Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia nuk mund ta mbështesin ekonomikisht përkthimin e autorëve të tyre në gjuhë të huaj, detyra e bindjes së botuesit është një aftësi e pashpresë.

K

KUJTIME

Aleksandër Moisi në kujtimet e aktorit austriak Fritz Eckhardt

NGA PJETËR LOGORECI

Vijon nga faqja 13

Natën e premieres, në rolin e një ushtari spanjoll nga vjeçti 1520, isha i veshun me jelek me gjoksore llamarine që natyrisht dukej si prej çeliku, me çizme të mëdha e pantallona shumë ngjyrëshe, e në kokë një helm të randë e të frigshme stolisë me pupla. Në dorë mbaja të veshuna doreza me mbulesë metalike. I transformuam në një "monstër" luftë, me të ndigjue "batutën" e pritun u futa me vrull në skenë duke citue me egërsi, me fytyrë nga publiku që kishte mbushë plot e përplot teatrin, frazën time të vetme.

Mandej heshtje.S'po ndodhte asgja.Pat një pause aq të gjatë sa fillova të mendoj se ishte fundi i dramës dhe pritishe ramjen e siparit, por ai s'po binte...

...por një lëvizje mjeshtrorë e të madhit Moisi, i cili si zakonisht qëndronte afër gropës së suferit, më bani që të frymtoj përsëri. Me disa lëvizje magjepsëse prej princi të vertetë, Moisiu erdhi drejt meje duke përsëritur lehtë sa dhe unë mezi e dëgjova: "...më godit... a ndjeve, më godit"... Unë s'po kuptojshë asgja dhe qëndroshë si i shushatun e fytyra ime kishte marrë një pamje qesharake nën helmten e shtetueme. Një fishkëllimë e gjeniu sikur me sollti në vehte... "Të thashë që të më godasësh, ti idiot!"

Ah, mendova, goditja ime duhet të jetë "shenja" kur ai duhet të fillojë batuten e tij..., dhe pa u mendue gjatë, e godita. Jo me t'gjithë forcën, por aq fort sa trupi i dobët i Moisiut u lëkund. Por përsëri Montezuma Moisi, duke lëvizë drejt meje, me za të butë më drejtohet: "...Pse s'po më godet fort?"


I çuditur mendova: a thu do të jetë teksti ashtu, që të kërkojë një goditje ma të fortë? Dhe godita, por kësaj herë me të gjithë forcën time prej 17 vjeçarit, me grushtin e mbështjellë me dorezë metalike. Moisiu fluturoj mbi parkmakët e skenës që e mbajtën pa ra në publik...mandej duke u ngrit ngadalë, me sy lutës mu drejtue me fjalët e roli: "...Me bjer, me godit për vdekje mik"... Atë natë unë, me të gjithë seriozitetin tim, rraha në skenë, sipas të gjithë rregullave të artit, yllin botnor Aleksander Moisiu.

Menjëherë mbas shfaqjes, me za të butë ashtu siç ishte dhe vetë ai, Moisiu mu drejtue: "Herë tjetër lexojë tekstin e dramës"... I skuqun në ftyrë i tregova se e njihja tekstin, por aty nuk shkruhej se duhet

Për teatrin gjermanishtfolës, aktori Franz Eckhardt, ishte një ndër figurat e dashutna e sidomos për publikun vjenez. Edhe pse kishte krye akademinë e arteve në Vjenë për art dramatik, ai ishte edhe këngëtar, skenarist, libretist, kabaretist e regjisor. Nana e tij, një aktore teatri, e la jetim në moshën 9 vjeçare, ndërsa i ati, që ishte drejtor teatri në Vjenë, u vra nga nazistët gjatë fushatave kundër hebregjeve.



pieter logoreci



pieter logoreci



pieter logoreci

Arthur Stadler: Alexander Moisiu als Montezuma Nach einer Bühnenfassung



pieter logoreci

oifji als Montezuma im „Weißen Schaub“.

ta godisja, që edhe asistent regjisorik nuk ma kishte thanë këtë detaj.

Sot, nuk mund të imagjinoj se çfarë unë do ti thojshe një aktori të ri, sikur ai të më rrihte në skenë edhe pse jam ai i fuqishëm e mbi peshe e Moisiut.

Moisiu si Kardinali Richelieu Një herë, i ftuem në teatrin e St. Polten, Moisiu interpretonte rolin e Kardinalit Richelieu në dramën me të njejtin titull të një autorit francez, që me të drejtë sot asht pjesë e harrueme. Si zakonisht pat vetëm një provë të Aleksandrit me aktorët vendas të cilët e kishin mësuar pjesën përpara. Moisiu i

cili ishte ulur qetësisht dhe po vëzhgoonte proven, po i tregonte një shërbëtorit që lajmëronte hymjen në skenë të Kardinalit/Moisi, se si duhej ta thonte batuten... "ndigjo miku im, ti duhet të jesh i kujdesëshëm në këtë lajmërim mbasi Kardinali Richelieu në kohën e tij ishte burri më i randësishtëm i kishës, si Papa...më kupton? Mos u ban qesharak, mos të merret goja, mos bëlbëzo ashtu si në provë, por me za të fuqishëm dhe stoik lajmëro: ...Shkëlqësia e tij Kardinali Richelieu..., më kupton, fuqishëm për burrin më të fuqishëm të kishës...

Por fjalët e Moisiut banë efek-

tin e kundërt, mbasi aktori/shërbëtor u turbullue shumë nga personaliteti dhe këshillat e Moisiu dhe ndodhi që atë mbramje në shfaqje, ai u fut me rrëmbim në skenë e duke marrë një qëndrim prej statuje lajmërojmëton të fuqishëm...Para jush Shkëlqësia e tij Papa...

Mbas shfaqjes, i zëmëruem, Moisiu po i fliste ashpër atij. Shërbëtor i lajmëtar, i fyer nga toni i mjeshtrit, reagoj me kambëngulje: "...Çke, pse zemërohesh? Ti vetë më the që ai asht burri më i madh i kishës, ...e një tjetër ma të madh se Papa nuk mund të gjej...

P

POEZIA

Autori përdor një figuracion interesant për artikulin e tij poetik. Frymëzimin artistik e ka si gjëndje të vazhdueshme, që e ushqen me një vëzhgim interesant të nënvetëdijës dhe botës që e rrethon...

Hipnozë në dimër

NGA PETRAQ RISTO

Revan me Fjalën

Tani po mësohem ti të Fjalës mëgojëz, ti të Fjalës një frë Ne barkun e bardhë me mamuze ta shpoj, Mbi kalin e Fjalës të rend si rrufe... po s' di ku të shkoj.

Një zë më thote: shko në Olimp, atje ku presin kaq shumë korifej
Po Fjala tërhiqet me dridhje në shpirt... mos velen gënjej?...
Eh, ç'kalë i bukur me hije dhe dritë... Terheq frerin dhe... kthej.

Kam kohë që ngas kalin në fushë të minuar: të shkoj në bregun përtej
Po Fjala ka shpirt, i duhet të vuaj: sepse çdo çast dika do shpërthej
Beleja patjetër duhet fituar... me kalin e Fjalës nuk mundem të kthej...

Brenda ortekut

1.
I gjallë brenda një orteku rrokullisem në malin e fatit tim.
Ku po shkoj? pyes malin po ai shungulloi nga kollitja e vjetër
Plak mizor numeron si tespie ortekët... Ku po shkoj?
Kur je brenda një orteku të tjerët të quajnë Orteku
Dhe ti mund ti shtypësh duke rënë
Dhe pse brenda arkivolit të bardhë: i pavdekur
Dënes me zë: nënë, o nënë!

Brenda një orteku rrokullisem si O-ja e një kllithme
I bardhë në zemër të errësirës. Zemra e ortekut: i pavdekur.
Rrokullisem. Jehona ime kafshon shpatet, honet, brigjet
Jam brenda një orteku... A mund të më hapni një dritare?
Një ortek i bardhë si hëna e plotë, si loti i ngirë
Glob i habitur përballë nxënësve që s' dinë përgjigjet
Po rrokullisem brinjët po kthehen në paralele e meridiane
Dhe zemra: flamur në hartën e luftës po digjet...

2.
Si brenda Gurit të Sizifit rrokullisem në thelbin e absurdit
Hapni një dritare ta shoh Hënësin si ngjit shkallët vetëlëvizëse të dallgëve.
I pafuqishëm në qendër të ortekut ndiej pranë dikë tjetër
Dihat e lutet: zefemër (Te dy në luftë për mbijetesë)
Ajo: gojë më gojë me një uj. Unë: gojë më gojë me një dhelpër...

Orteku rritet: kafshë, shpendë, rrënjë, degë, flatra kllithmash, kembë...
Një uj dhe një dhelpër: të ngordhur
Ajo thith ajër nga një uj. Unë me dhelpërin: gojë më gojë...
Te shpëtojme! Te shpëtojme! Te shpëtojme!

Orteku paprimtas ndal rrokullisem
(Maja e një shkëmbi na dëgjoj lulet, s' na lë të shkojmë më tutje)
Ajër! ... Ajër! ... Thërresim me vete
Ajo: gojë më gojë me një uj.
Unë: gojë më gojë me një dhelpër...
Një dorë, dy duar, dhjetë duar...
Na i hapën, na i hapën dritaret
Shpëtuam unë dhe ajo
Ujku dhe dhelpëra: të vdekur
Fati: Hero...

Narcizi

1.
Ti ishe shtëmba në syrin e burimit: të kapja në vegjet e kraheve, të ngrija lart
Nëpërmet buzëve të pija të pija: shuaja etjen me dashuri njerëzimi.
Shtëmbë në zinxhirime halkash burimi.
Një shtëmbë e pjekur mirë, me lëkurë njeriu dhe qielli
E fresket, aromë nalyre ... shuaja etjen me dashuri njerëzimi.
Kisha elje, pija dhe pija e s' ngopesha nga dashuria.

2.
"Bëra pronë një burim ku qe fshehur Narcizi
Po s'e bëra Narcizin skllav, kurrësi



Dhe pse halka-halka zinxhironte burimi
Dhe lofolata lotonte nga bukuria e tij...

Kush e vrau Narcizin s'e di...
Burimin kam albi...
Halka halka zinxhiri në buzët e mi
Dhe pse e burgosur, çdo çast Narcizin pi...

Hap dyer...
Hap dyer një, dy, njëzetë, pesëdhjetë... dyert e botës hap
Një liber të madh me dyer shfletoj fletë-fletë, lexoj dhe i mbyll
prape.
Hap dyer nga mëngjesi në darkë: doormen" i shkëlqyer
Jakë hene dhe qiellin për fram. Mijsëra dyer...

*Punonjësi që shërben të hyrja kryesore e ndërtesave të mëdha.

Nga bota e përtejme u kthye një njeri

Më në fund nga bota e përtejme u kthye një njeri
i veshur si në ditën e vdekjes me një karafil të kuq
te xhepi i xhakelës së zezë te xhepi sipër zemrës.
Teper serioz ecte mes deborës që binte në mënyrë habitore.
Kureshtarët shihnin se ai linde gjurmë se kish veshur po ato këpucë të zeza.
Duhej të shikonte sepse i mahnitur nga debora që binte ngriti kokën nga qielli:
abetare nga binin shkronja debore dhe nisi të lexonte.
Kish mbetur i ri si në ditën e vrasjes dhe pak rebel si atëherë
Paprimtas mblodhi deborë të bardhë dhe me të bëri një njeri të cili i vuri në gjoks karafilin e kuq.
S'u kujtua për plagën e tij sepse paprimtas rringriti kokën nga qielli dhe kllithi...
S'e dime nëse shkronjat e deborës ia zbuluan sekretin apo karafilin.

Ditët e balonave

Me një brisk kujdesi prisnin kallamat e hollë: eshtra zgjosh
Pastaj letë me ngjyra: lëkurë dëshirash
Me pak kollë e fije të hollë ngjizet ëndrra jonë

Era u jepte jetë në qiell. Sa balona ka femijeria!
Balonat fluturonin më lart se zogjtë. Mburra kish flatra.
Mes gishterinjve me një fije të hollë i çonim kode qielli: Tirrej
Liria.
Në fund të ditës balonat këputeshin, era hynle nga ohaqet në valra
Na fronte për balona të reja: me lëmsnin e zemrës,
me lëkurë në vend të letërës dhe brinjët e gjoksit për kal-

lama...
...
Si dalluj dot mjellmat memecë nga mjellmat trumbetare
Di që trumbetaret, kur preken, bërtasin fort
Dhe memecet kur vdesin bëhen qengetare.
...
Ti pi salep nga rrënjë orkideje dhe çaj nga lule kamomili
Unë pi raki nga një vreshtë rrufeje dhe dashuri nga trëndafili.

Kam frikë...

Kam frikë, s'e di pse kam frikë
Për të trembur frikën dëgjoj muzikë
Po dhe muzika ka frikë.

Në errësirë, në errësirë, kam frikë
Hap dritën po dhe drita ka frikë
Ngritëm nga shtrati se dhe shtrati ka frikë

Kam frikë ta hedh hapin, kam frikë.
Ca hapa kerkojnë të më kapin
Vrapoj dhe vrapoj ka frikë.

Të ik, tu të ik, vendet ku shkel paskan frikë
Fytyrat e shokëve, kam frikë
Dhe sytë e të tjerëve kam frikë

Shpëtova nga lufta, kam frikë
Fytyrat e shokëve, kam frikë
Kam frikë dhe nga lujja, kam frikë

Vetëm nga Vdekja s'kam frikë
Po Vdekja s'më merr...
Se ka frikë...

Hipnozë në dimër

1.
Shiko pendulin majtas - djathtas, jo qendrën të lutem, majtas - djathtas...
Një pendul është bosht mendimi, zhvendos hijen brenda shpirtit.
Majtas - djathtas. Çfarë mban mend nga nata e fundit?
-Hëna e plote - pistë akulli ku kërcejnë drerët e krishtlindjeve
Dhe një vrasës me beretë që rreth pistës vërtitet
Dhe e qeshura ime sfiduese dhe bora që më gradonte supet

Pastaj bora përgjaket, çgradim(r)i i supeve...
Lakuriq. Mes borer: lakuriq. Hëna e plote dhe drerët mes ujëve...
Qellova unë dhe ujku u shemb nën këmbët e mia
Gjaku e ktheu berelën në varkë...
Penduli lekundet majtas dhe djathtas
E vërteta lundronte drejt qendrës me gjak...

2.
Ti kishe qetësinë dhe vlagën e livadhit të sapokorur
Unë shkëlqimin dhe ngrohtësinë e kosës.
Nuk pendohej vesa që po binte nga hapësira, jashtë kohës.
Nuk pendohej drita që të jepte madhështit statujë
Dhe hiya me truket e veta të vishte mendafsh trishtimi
Nuk pendohej pasqyra që me ligjin e ujrave
U shpërdante brigjeve pasqyrimin.
Askush, askush nuk pendohej, veç pëllit që ndiente avullimin...

3.
I qetë si kulla e Grinuçit në meridianin Zero,
ku rremat e akrepave çajnë delin e kohës
Nuk ka kohë, ora është thjeshtë ingranazh gjenjeshlar që ha
fëmijët e vet
Rremojmë me dy akrepa dhe kthejmë shpirtat në det.
Rremojmë me kater duar dhe dy zemra dhe mendime të ndryshëm
Fari që luan symbyllazi me horizontin e vet
Dallgët që shprehen: psallme të magjishëm
Dhe një breg që çfaqet pa e ditur çfarë pret.

Kanë lulëzuar dhogat e hambarit të vjetër: gurë dhe misër
Dijetë metra larg bregut në vitin e madh të urisë.
Zbresim në ishullin e vogël pa Robinson, pa Circe, pa Ciklop
Veç unë dhe ti dhe fari që rrotullohet: habi e çakërditur
Dhe ky ishull në formën e sisës.
Dhe një Hënë e kuqe si shenja STOP!
Dhe në breg valet lozin me kafkën e ironisë

Çfarë ka?!... Erdhën kanibalet?!... Po zgjohem gjarpërinjtë?!...
Kim Jong-u atomik e ka ishullin shënjestër?!...
Nxjerrim varkën në kum, e lidhim në një spirancë të vjetër
STOP-in e Hënës e mbulon një robe-reje
Në mbulohemi me lodhjen dhe krahet e njeri - tjetrit
Frymëmarja astmatike e farit dhe regjimat e zemrës.

4.
Sytë e tu: dy humnera ku bien ujrare e burimit të zi
Dhe dy ishujt e gjinjve me fare e thithkave
Dhe ishulli ynë në formën e sisës
Pellumbat dhe zogjët çukësin majat e barit mbi borë
Një dimër i lodhur, cinik, me masterplan përmbijtesh
Me pranga ngrice në dorë dhe stalaglitë-pikëçuditësesh.

Dhe ishulli ynë në formën e sisës.
5.
Ku je armiku im, të përshëndes, armiku im
Fshije pluhurin nga robet e udhëtarit
Dhe gjë një konak të fjalës Gabim.
Asnjëherë nuk je vonë, armiku im.
Gjithë shiu që bie me duf lëngate, bie për ty, armiku im
Dhe oqeani që flet me gjuhët e dallgëve
Natyrisht e ka një mendim, apo jo, armiku im?...
Vishu serioz, me kostum të erret
Na duhet dhe njëherë ta varrosim Lirinë
Ti e vrave, unë ia mora zemrën
Të ndrihtë te Poezia si në vitlinë...
Të dy jemi fajtorë, armiku im!

...
Sol m'u shfaq Perëndësia e Mjegullës: i dukeshin vetëm
sytë dhe majat e gjinjve
Dhe një bistak rrushti shkëputur prej pjergullës lëngëzonte
mes dritës dhe hijeve
Dy sytë dhe majat e gjinjve...
Sol m'u shfaq Perëndësia e Mjegullës: i dukeshin dy buzë
dhe dy kupat e gjinjve
Dhe një yll i vogël pikuar prej ëndërrës ia llate trupit florinrin e kallinjve.
Dy buzë dhe dy kupat e gjinjve...
Dy sy, dy buzë, dy gjinj, rrush dhe kallinj
Dhe unë i hutuar mes mjegullës
Nuk di nëse shkoj apo vij...

A

ARGUMENT

Studiuesi i njohur i fotografisë i dedikohet mikut të tij piktor me këtë shkrim nderues dhe shumë të përkorë

Një portret dhe...ca rreshta për Skënder Kamberi

NGA QERIM VRIONI

Reth dhjetë vite më parë, u organizua nga Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë, një ekspozitë e veçantë e arteve pamore. Në këtë veprimtari, autorë të njohur të tablove kompozicionale të kohës së diktaturës do t'i riktheheshin atyre duke krijuar para publikut mbi idenë e punimeve të tyre të vjetra, *tela*jo të reja. Ndërmjet shumë artistëve të ftuar ishte edhe piktori i njohur Skënder Kamberi (dt.1939), Piktor i Popullit, mikut im i hershëm.

Ndër veprat më të mira të Skënder Kamberit, studiuesit e artit shënojnë: "Ndihma e shokut"(1966), "Rrethimi i Krujës (Vrana Konti)" (1968), "Portreti i Poetes Maro Pasho" (1973), "Buka e duarve tona"(1976) dhe "Në Belvedere në Vienë, sikur pashë Skënderbenë"(1977). Piktura të tij, kryesisht kompozime, përveçse në organizime të ndry-

shme kombëtare, ku janë vlerësuar me çmime, janë ekspozuar edhe në disa shtete, si Egjipt, Francë, Angli, ShBA, Itali, Greqi, Gjermani, Turqi etj. Me penelat dhe telajot ai vazhdon edhe sot të *takohet* thuasje çdo ditë.

Mbaj mend se atëherë, Skënderi kishte dëmtuar gishtin tregues dhe atë të mesit të dorës së djathtë dhe punonte pasi i kishte fashuar mirë ata, por disi me vësh-tirësi. Ai do rikrijonte mbi një kompozim të tij të her-shëm, subjekti i të cilit lidhej me Kongresin e Lushnjës (1920) dhe caktimin e Tiranës si kryeqytet të Shqipërisë. Figura qëndrore e tablosë origjinale ishte një vajzë e cila shpaloste Flamurin Shqiptar dhe i ngjante një shqi-ponje. Mbase kishte shumë patetizëm brenda saj, veçse në të binte në sy, sidomos e kuqja e Flamurit, mundet edhe sepse kështu e kërkonte koha.

Në kompozimin e ri, Skënderi nuk ndryshoi shumë gjera në krahasim me të vjetrën, por për arsye a nxitje




Foto Qerim Vrioni, 2008

që vetëm ai i dinte, i hoqi të gjitha teshat vajzës dhe e paraqiti të shveshur. Ndoshta prej vitesh atij i *hanin duart* dhe i *dignin sytë* për të pikturuar dhe ekspozuar publikisht një femër krejtë të zhveshur, ose si i thonë në arte, një *nudo*. Gjatë kohës që ai vizatonte tablonë, e fotografova nga afër, ashtu të zhytur në pikturën e tij disa herë, prej tyre zgjodha këtë. Ishte tetor i vitit 2008.

A

ARKITEKTURA

Arkitekti Andi Papastefani është duke skicuuar Tiranën e harruar, atë që sot fshihet nga ndërtesat shumëkatëshe dhe ndërtimet e shumta pa kriter. Në këtë numër, po botojmë pak vizatime të tij, bashkë me një sqarim, ku ai flet për një teknikë ndërtimi, me të cilën identifikoheshin shumë objekte në Tiranë.

Rekuiem për Tiranën e përkorë

Arkitekti Andi Papastefani është duke skicuuar Tiranën e harruar, atë që sot fshihet nga ndërtesat shumëkatëshe dhe ndërtimet e shumta pa kriter. Në këtë numër, po botojmë pak vizatime të tij, bashkë me një sqarim, ku ai flet për një teknikë ndërtimi, me të cilën identifikoheshin shumë objekte në Tiranë.

"Nga vitet '30 filloi të përdoret një teknikë e thjeshtë por rezistente, siç e tregoi koha e betonit me granit të çukitur.

Guri i Shallvares, muri i ulët që rrethonte Parkun "Rinia" e muri që rrethonte lulishten e zhytur pas Skënderbeut ishin me këtë material, që sot janë zhdukur ose zëvendësuar.

Muri mbrojtës i shkallës tek Stacioni i vjetër i Autobuzëve, pas Bashkisë ka mbijetuar deri më sot, dhe është realizuar prej këtij materiali.

Gjithashtu kolona si tek ndërtesa në Rrugën e Kavajës dhe shkalla tek ministritë janë realizuar me një teknikë të tillë".



N

NDERIMI

I biri i poetit flet në emër të të atit

NGA ORGEST SPAHIU

Të nderuar familjarë të dëshmorëve!
Invalidë dhe veteranë të UÇK-së!
I nderuar Kryetar i Komunës së Rahovecit!
I nderuar kryesues i Kuvendit!
Të nderuar këshilltarë komunal!
Të nderuar të pranishëm!

Është një gëzim i madh të jemi me ju sot, duke festuar një ditë kaq të bukur dhe të dëshiruar, ditën e lirisë së Kosovës. Për t'ju përshëndetur në këtë ditë në emër të poetit po ju sjell vargjet e tij kushtuar lirisë së Kosovës. U shkruan prej tij në vitin 1990 dhe e quajti

KËNGA E LIRISË

Nga Xhevahir Spahiu
Toka, qëngji i therur, përpëllitet.
Pyet bari: ç'do të thotë jetë?
Pyet i vrari: hyj a dal në mesjetë?
Si lumenj të turbullt,
nga zemërimi 'asin përçarë poetët.
Plumbin ua vodhën,
me plumb i goditën,



gotat delirante kryeqyteteve ngritën. Po foshnja e mbytur në gjak, po plaku i këputur në prag, edhe të vdekur shpallin shpagë e fjalë zgjimi: Bashkimvëllazërimi - perdekrimi. Po këngët, këngët a do të gdihen pa pranga? A do ta shkulë jeta me dorën e vet atë thikë të ngulur mbi shpinë? Kosova është në muajin e nëntë dhe do të pjellë lirinë.

(1990)

Poeti u pyet nga miqtë e tij pasi kaluan 9 muaj: "Kur do ta lindë Kosova lirinë?" dhe poeti u përgjigj: - Prisi, prisi dhe pak.. U deshën 9 vite që të përmbushej profecia e ndërjerë e kësaj poezie. Kosova e polli lirinë në qershor 1999. Sot jemi bashkë këtu për të festuar 11 vjetorin e pavarësisë së Kosovës, këtë ditë të shenjtë për historinë tonë. Është një nder dhe emocion i veçantë për poetin të jetë këtu në këtë ditë të shënuar të lirisë së Kosovës e të nderohet nga ju.

Faleminderit nga zemra Rahovecit!

RAHOVEC, 17 shkurt 2019

...nga numri i shkruar

"Milosao" e këtij numri mund të konsiderohet relativisht e mirë. Shkrimi kryesor i kushtojë Manastirit të Shën Kollit në Mesopotam, realizuar nga Restauratori Reshat Gega. Problematika që ngrihet ai ishte shumë shqetësuese. "Dëmi mbi vlerat arkitekturore, historike dhe artistike që u implementuan mbi Kishën e Shën Kollit në Mesopotam, është i tejkupshtëm në dimensionin e vet. Ndërkohë ndodhja në fjalë e përfshirë nga një nxitim i dallidur, drejtuar nga një ambicje injorante, e shtyrë dhe e ushqyer nga dëshira për të shkelur mbi punën studimore disa vjeçare të tjetërkujt, pra një shkelje flagrante e të drejtës së autorësisë dhe pronësisë intelektuale, është një tjetër aspekt i shëmtuar e i turpshëm për ata që bëjnë protagonizmin në këtë rast. Jo vetëm kaq, por aventura shkon më tutje". Autori mund të ishte pak më i kursyer me gjuhën e përdorur, pasi akuzat nuk na nevojë për ngjyresa. Nuk ka asnjë reagim deri më tani, paqka se ditë më parë shkrimi u zhduk papritmas nga online. Këtu vendi duket se pak i dhimbet kultura.

Ndrek Gjini, bashkëpunëtor i tjetër, na sjell memorandum in e Dom Kaçoritit përcjellë Mbretit të Austro-Hungarisë, Franz Jozefit I: "Shumë të vështirë e të rrezikshme janë këto ditë për ne shqiptarët e për nanën tonë Shqipërinë që të katër shtetet e Ballkanve po dojnë me e përpri e me copturi". Autori mundohet të na sqarojë rëndësinë e aktit, duke na kujtuar se: ky memorandum i që dërguar Mbretit Franz Jozefit I ndodhi vetëm gjashtëmbëdhjetë ditë para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Diplomati dhe përkthyesi Kujtim Morina është i veçantë sa i përket përzgjedhjeve të tij. Këtë herë na kish sjellë Robert Frost, një autor të jashtëzakonshëm, që ka dhënë aq shumë për poezinë klasike. Trajtimi i tij i poezive ishte shumë i kujdesshëm, por edhe që e tregon autorin shumë të realizuar në këtë angazhim suplementar.

Anna Kove na ka shkruar diçka për "Ditët e lakuriqëve të natës", që sipas saj, është një roman aspak i ngarkuar me element të absurdit, përkundrazi, duke qenë në thelb realist edhe në elementet e tij magjike, është krejtësisht i kuptueshëm për lexuesin. Gjuha e gjallë dhe e pasur është një nga pikat e forta tashmë të shkrimtarit Namik Dokle. Ajo pasqyron jo vetëm koloritin jetësor të zonës, por identifikon dhjetëra e dhjetëra personazhe në mënyrë krejtësisht të dallueshme. Asnjëri nuk flet. Rexhep Ferri na solli një përshkrim të karakterin thellësisht metafizik, ku atdheu, nocionet, morali futen në një qerthull, ku është vështirë të gjykojë. Akademikun ia lehtëson puna në shkrimin e ese-së njohja e disa fushave dhe abstragimi i lehtë i kuptimit të jetës, falë përvojës dhe gjykitit të ftohtë... shkroi redaktori.

Tatjana Haxhimihali, bashkëpunëtorja e hershme e "Milosao" na ka sjellë disa mendime për librin "Rrëfime - jeta si kirurg i trurit" nga Henry Marsh. Motivimi i tij është puna, një punë cilësore, që përpiqet t'ua fusë në shpirt edhe bashkëpunëtorëve e nxënësve pasues me shembullin që jep në realizime operacionesh të vështira, shpeshherë edhe në kushte jo të përshtatshme. Patëm disa kritika për shkrimin e saj, që nuk e kuptuar sensin...



Redaktori e solli edhe njëherë debatin për "Piramidën", duke parë katrahurën sesi po katandiset hyrja e saj. Paqka se është stërforul, se do të bëhet një qendër e madhe inovacioni, na sjell apelin e madh që kjo godinë duhet të bëhet Bibliotekë Kombëtare, në mënyrë që të justifikojë rëndësinë e vet, por edhe t'i japë zgjidhje problemit pa zgjidhje të këtij institucioni. Për fat të keq, megjithë punën gati heroike të punonjësve të saj, Biblioteka e sotme Kombëtare vuan pamundësinë e kryerjes si duhet të funksionëve të saj për shkak të vendit, por edhe hapësirave të duhura...Redaktori kishte bërë një gabim të madh që nuk kishte vënë imazhin. Për këtë duhet fajësuar disi edhe layout. Numri mund të konsiderohet i mirë.

LIBRI

Bashkim Hoxha është një rrëfimtari i këndshëm dhe një autor që e njej mrekullisht dialogun. Kjo i jep lehtësinë që çdo temë mund ta zërthojë lehtësisht. Kështu ka ndodhur dhe këtë herë me gdhendjet interesante në vepër të personazheve por edhe përshkrimin për metamorfozat e çuditshme. Evolucioni i personazheve duket sikur i paraprin kohëve, por në fakt janë këto të fundit, që autori i ndjell përpara personazheve të tij...

“Kronika e mjegullës” së një vendi

NGA BEN ANDON

Metafora, e cila vjen nga titulli, është gjetja më e bukur e autorit për librin e tij "Kronika e mjegullës". Në një sens që të kap pak metodën e Realizmit Magjik, autori na sjell më së miri atë që ai mendon për vendin e tij, kurse romani si gjinia e zgjedhur është thjesht shtrati ku vendoset shtjella e idesë së tij, që duket se është tjerrur për shumë kohë. Por, në fakt, kush më mirë se letërsia mund të shpjegojë historinë e një vendi.

Bashkim Hoxha ka një korpus të tërë veprash në gjini të ndryshme, porse kjo vepër, sipas tij, i është dhimsur. Kjo ka qenë Shqipëria dhe mendimi i tij i plazmuar për vendin e tij, sintezë e mendimeve, punëve të tij personale dhe një eksperience të dashur. Rrëfimi i autorit zgjidhet me disa regjistra, veçse narratori është zgjedhur në veten e tretë për ta menaxhuar i qetë të gjithën.

Azis Beu, një nga personazhet kryesore, potenciali i tij kulturor dhe kamja do të kenë një fund të hidhur, ashtu si Hëna, që e nis nga hiçi kalon në apogje dhe na përcjell në pleqëri deri te brezi i tretë i saj, që e përfaqëson Kristela, mësuesja e historisë, e cila në fund dëgjon amanetin e padëgjuar të gjyshes, që donte të vdiste e virgjër!!!

Vetë virgjëria është një figuracion në këtë vepër dhe në një farë mënyre rrëfen se edhe me atë në tallimi, ashtu si tallimi me çfarëdoqë tjetër. Autori e ka zgjedhur përmes një ligjërimi universal, por kuptohet me shumë trishtim që ia dedikoi vendit të tij dhe e zërthen me një personazh: "E përdhuron jeta njeriun, ia merr virgjërinë. E shkel me këmbë. I gjuan me shpulla. E shkërden me zor jeta njeriun. Njeriu vjen në jetë i bardhë si dëborë. Por edhe dëborën e shkelin me këmbë, vijnë njerëzit dhe ia prishin bardhësinë. Nuk flas pastaj se si e dhjesin qentë atë bardhësi".

Linjat që ndërthuren janë të lexueshme, por fati i tyre është pak i befte nga autori, që e shtrin talentin e tij qartë sa i përket sensit të masës në kompozicion. I vetmi



shqetësim është momenti i fundit, kur autori me një ngut jo të natyrshtë mbyll vepren e tij. Kjo është edhe pjesa që ndoshta mund të zgjidhet me një epilog, por që autori e zgjidh me figuracionin e mjegullës. Nguti e lë pak pezull vijën që i bashkon të gjitha, por që gjithësisht është përsëri zgjidhja e autorit, e cila duhet të shprehë se duhet të vlerësohet më së miri.

Shikimi klasik, mbështetur në kanonet e letërsisë, i jep një vend të mirë romanit në atë tematikë që i kushtohet historisë së letrarizuar të vendit, por që duhet shtuar se autori kishte mundësi ta trajtonte që në fillim me atë sens akuareli që ka hapur romanin dhe përcjell metamorfozën e Hënës.

Bashkim Hoxha është një rrëfimtari i këndshëm dhe një njeri që e njej mrekull-

isht dialogun. Kjo i jep lehtësinë që çdo temë mund ta zërthojë fare lehtësisht. Kështu ka ndodhur dhe këtë herë me gdhendjet interesante në vepër të personazheve por edhe metamorfozat e çuditshme. Evolucioni i personazheve duket se i paraprin kohëve, por në fakt janë këto të fundit, që autori i ndjell përpara. Dhe, koha e re që vjen nga fillimi i vepres dhe përkon me Lindjen e Shqipërisë së Pavarur "i bën vend" Cubit, që ekzekuton burrin e parë të Hënës. Është ajo çka e pret Azis Beu dhe të birin nga ardhja e gjermanëve, ashtu si bijtë e Hënës, përfshihen në luftë dhe përfaqësojnë tashmë një komunitet, që do të ndikojë shumë për protagonistin në veprat tona të historisë. Dhe, në fund cvirgjërimi dikur i lejuar nga vetë Hëna rikthehet por kur kjo e fundit në moshë të madhe "cvirgjëron" publikisht Azis beu, tashmë pjesë e klasave të përmbysura dhe në fund, i përjetësuar te shkolla ku jep mësim mbesa e presë së tij!!!

Pjesa e fundit, që lidh një metamorfozë të bukur të vlerësimit të historisë, është ironia e bukur dhe ideja e autorit për historinë tonë dhe jo vetëm, një mesazh që Bashkim Hoxha e ka zgjidhur qysh më parë, sërish përmes personazheve të veta: "Historia nuk do të shkruhet po të mos ishte e dobishme: E dobishme për çfarë? Për të sotmen. Kur shkruajmë historinë, ne korrigjohem disa gjëra ose u japim kuptim të ndryshëm gjërave që kanë ndodhur në varësi të asaj që jetojmë sot. Ja, për shembull: heqim Masarin dhe vëmë Harunin. Me këtë rast themi dy fjalë më shumë për mbretin dhe familjen e tij në histori. Dhe kjo e bën më të mbështetur historikisht mbretin në vepër të tij në dobi të përparimit...". Kjo është ironia e bukur e autorit por edhe një qortim për të gjithë atë që ka ndodhur me historinë dhe zhgënjimin tonë permanent të gati 110 viteve.

E fundit, duhet cilësuar një element i bukur dhe shumë teknik që i lidh të gjitha kapitujt, dhe që bëhet gati përmes një elementi montazhi, ku momenti i fundit, i paraprin fillimit të kapitullit të ri. Mjeshtëria e autorit, është se duket që ai e bën vepër që ta shijosh gati dhe si skenan. (Milosao)

TITULLI: KRONIKAT E MJEGULLËS

AUTOR: BASHKIM HOXHA

GJINIA: ROMAN

FAQE: 232

ÇMIMI: 1200LEK

BOTUES: ONUFRI

Intervista e Ditës

NATO druhej mos Rusia pushtonte Kosovën

Nga Jamie Shea

(vijon nga faqja 1)

... një prani e pashmangshme në televizione për muaj të tërë.

Sot veterani tashmë në pension i NATO-s ka një profil më të ulët publik si profesor i Strategjisë dhe Sigurisë në Universitetin Exeter në Anglinë jugperëndimore.

Në një intervistë për programin televiziv të BIRN Kosovës "Jeta në Kosovë" për fushatën e NATO-s, që i dha fund sundimit serb në Kosovë, ai kujtoi "momente tronditëse dhe të tensionuara" në qershor të vitit 1999, kur trupat ruse hynë në Kosovë nga Bosnja dhe konfiskuan aeroportin e Prishtinës para se të mbërrinin trupat e NATO-s.

Për disa ditë, flitej për një përballje, madje edhe për luftë, midis NATO-s dhe Rusisë mbi ish-krahinën e atëherëshme serbe.

"Rreziku i vërtetë që patëm atë ditë të veçantë ishte shqetësimi se rusët do të dërgonin forca të specializuara, më shumë forca, direkt nga Rusia, mbi Europën Lindore dhe në Kosovë për të përfurcuar trupat ruse që kishin vazhduar përpara, kështu që ne do të kishim të bënim me një kontingjent shumë më të madh rus, i cili mund të zinte pjesën veriore të Kosovës apo ndonjë sektor tjetër", - kujtoi Shea.

Kjo perspektivë bëri që planifikuesit e NATO-s të shqetësoheshin se Kosova do të ndahej si Gjermania midis zonave ruse dhe perëndimore.

"Imagjini Berlinin në Luftën e Dytë Botërore", - shpjegoi Shea, duke kujtuar ndarjen Lindje-Perëndim të kryeqytetit gjerman pas luftës, e cila vazhdoi për pothuajse gjysmë shekulli.

Për Shean, ai moment i caktuar i tensionuar përfundoi kur Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia, të cilat sapo kishin hyrë në aleancën e Atlantikut të Veriut, bllokuan hapësirën ajrore të tyre dhe kështu ndaluan Rusinë që të dërgonte trupa shtesë nga toka ose ajri.

Si përfundim, kontingjenti i trupave ruse u tërhoq brenda disa muajsh, kujton Shea, duke lënë NATO-n nën kontrollin e vetëm të territorit të Kosovës. Bllokimi përfundoi.

Mijëra serbë u larguan nga Kosova pas kolapsit të sundimit serb, por Shea thotë se NATO-ja pengoi spastrimin etnik të llojit që ndodhi në Bosnje.

"Jam i lumtur që NATO-ja ishte në gjendje të ndalte spastrimin etnik në Kosovë dhe mësoi mësimet e Bosnjës që ishin vërtet shumë tragjike" - tha Shea.

Njëzet vjet më vonë, Shea nuk e nënvlerëson rrezikun që Rusia të zgjerojë ndikimin e saj në rajon. Por ai, gjithashtu, këmbëngul



se Ballkani është i orientuar drejt integritimit euro-atlantik në përgjithësi dhe Rusia ka fituar pak terren.

"Nëse bëni një hap pas, sidomos gjatë këtyre 20 viteve, dhe shikoni se cili ka qenë drejtimi i përgjithshëm, ka qenë se 99 për qind e rajonit po i afrohet më pranë strukturave të NATO-s, BE-së dhe integritimit euro-atlantik", - tha ai.

"Nëse do të isha presidenti Vladimir Putin, sigurisht që nuk do të shihja se unë jam fituesi në këtë proces", - deklaroi ai në mënyrë të vendosur.

Shea shprehu krenarinë se ai kontribuoi në atë që ai e quan sjell-

jen e lirisë për shqiptarët e Kosovës.

Por ai nuk i mbështet të gjitha zhvillimet e fundit në vend, sidomos në lidhje me formimin e një ushtrie të Kosovës, të cilën NATO e ka kritikuar.

Ai shprehu dyshime më parë për mençurinë e transformimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës të armatosur lehtë në një ushtri të rregullt në vitin 2017, në një intervistë tjetër për BIRN.

Ai mbetet skeptik sot për mënyrën si janë bërë gjërat.

Në vend që të ndryshonte Kushtetutën për të formuar një ushtri, e cila do të kërkonte mbështetjen e deputetëve të pakicës ser-

be, Kosova zgjodhi një rrugë tjetër, thjesht duke ndryshuar kompetencat ekzistuese të FSK-së.

Shea tha se do të kishte preferuar një transformim të rregullt Kushtetues të FSK-së në vend të procesit që u përdor - transformimin e FSK-së nëpërmjet një ligji të posaçëm të miratuar në dhjetor të vitit të kaluar.

Ai tha se veprimi sipas procedurës normale, e cila përfshin një konsultim të gjerë me NATO-n, aktorët lokalë dhe pakicat, do të kishte bërë një forcë më "multietnike".

Megjithatë, Shea këmbënguli se Kosova është e sigurt ndërkom-bëtarisht dhe shpreson që shoqëria kosovare të përdoret më shumë në çështje si arsimit dhe jo të sigurisë.

"Ka disa anëtarë të NATO-s të cilët do të ishin të lumtur të kishin 5,000 trupa të NATO-s në territorin e tyre, kështu që Kosova është një vend i mbrojtur ndërkombëtarisht" - përfundoi ai.

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të zbulojnë një hobi të ri. Mund të dedikoheni ndaj modës ose mund të përfshihen në një formë ekzotike kreativiteti. Ka gjasa të nisni një lidhje të re dashurie, e cila do t'ju sjellë emocione të papërshkrueshme.

DEMI

24 shkurti do të kalojë pa ndonjë ndjesi të veçantë. Duhet t'i jepni prioritet marrëdhënieve familjare. Ka gjasa që të bëni një udhëtim ose të takoni miqtë. Përpiqui të ruani qetësinë teksa keni një javë të gjatë përpara.

BINJAKET

Binjakët do të kalojnë një ditë të qetë. Ata që duan të fitojnë popullaritet, do të ishte e udhës të promovonin talentin e tyre. Sa i përket marrëdhënieve suaj të dashurisë nuk do të keni probleme, por as nuk do të keni ndonjë arsye për t'u kënaqur.

GAFORJA

Përpiqui të shoqëroheni me persona të të njëjtit mendim. Kjo këshillë vlen veçanërisht për ata që duan të nisnin biznesin e tyre apo që janë në kërkim të një projekti të ri. Ndoshta nuk do të keni dëshirë të përfshihen në punë shtëpie.

LUANI

Luanët nuk rekomandohen të përfshihen nëpër rinovime. Ndoshta nuk është ende koha e përshatshme për ju. Do të ishte më mirë të hartoni një plan strategjik dhe të mendoheni me kujdes rreth së ardhmes.

VIRGJERESHA

Mund të përfshihen në një konflikt me një prej të afërmeve tuaj. Bëni mirë të mbani veten nën kontroll ose situata mund të përkëqesohet. Ndërsa në mbrembje do të kaloni momente shumë këndshme nën shoqërinë e miqveve tuaj. Madje mund të merrni edhe një dhuratë.

PESHORJA

Do të ishte e udhës të mos bënit shumë kritika. Kontrolloni mirë fjalët, përndryshe mund të ofendoni personat rreth jush. Filisni më shumë me familjarët, pasi do të ndikojë mirë në gjendjen tuaj psikologjike.

AKREPI

Akrepët ka gjasa të lodhen si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Rreziku për të humbur shumë energji është i lartë. Megjithatë, mbrëmja do të jetë romantike nën shoqërinë e partnerit/partneres suaj.

SHIGJETARI

Mos e kaloni të dielën duke u përfshirë nëpër debate në familje. Çdo gjë mund të zgjidhet nëse bëheni tolerant. Mendoni vetëm për mënyrat sesi mund të arëtoheni gjatë kësaj dite. Ndoshta mund të organizoni një udhëtim me miqtë tuaj.

BRICJAPI

Bricjapët do të kalojnë një të diel të paharrueshme. Madje kujtimet e kësaj dite do t'i mbani mend gjatë. Mund të bashkoheni me ish-partnerin/partneren tuaj, çfarë do t'ju emocionojë pamasa.

UJORI

Ujorët duhet të tregohen më të kujdesshëm për shëndetin. Mund të zbuloni shenjat e para të një sëmundjeje kronike. Përgjithësisht do të jetë ditë e qetë. Mbrëmjen do ta kaloni pranë familjes suaj.

PESHQIT

Do të jeni në qendër të vëmendjes gjatë kësaj të dielë. Madje ka gjasa të fitoni interesin e dikujt që mund të bëhet partner/partnerja juaj. Por bëni kujdes, pasi mund të ketë xhelozri rreth jush. Rekomandohet ta kaloni mbrembjen në qetësi ose duke u fokusuar tek e ardhmja.

Opinion *i* Ditës

Nuk na duhen zjarrfikës të huaj politikë, por zgjedhje demokratike

Nga Koço Kokëdhima


(vijon nga faqja 1)

... për 'Republikën e Re', kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare pa qeverinë e Edi Ramës dhe një reformim të thellë të procesit zgjedhor, ku të mos ndodhte më që populli voton dhe partitokracia numëron votat. PD-ja i tradhtoi këto kauza me pazaret në tavolinë.

Tani jemi rikthyer dy vite pas. PS-PD-LSI po kacafyten jo për t'i kthyer pushtetin popullit, por për pushtetin, interesat dhe amnistimin e krimeve të tyre. Pasojat e përlshjes së tyre nuk do t'i vuajë askush më shumë se sa vendi dhe populli.

Faktori ndërkombëtar pritet që të ndërhyjë sërish për t'i pajtuar në tavolinë, që ata t'i bëjnë lëshime, t'i japin garanci, imunitet, alternativim dhe përjetësi në pushtet njëri-tjetrit. Kjo nuk i duhet askujt përveç mafisë së tri partive.

Kriza të tilla kemi parë mjaftueshëm këto dy dekadat e fundit. Ndërkombëtarët, në emër të stabilitetit, kanë mbyllur sytë dhe veshët përballë rrënimit të shtetit ligjor dhe vlerave demokratike, kanë mbështetur qeveritë dhe partitë, duke braktisur popullin sh-



qiptar:

Kjo nuk duhet përsëritur në vitin 2019. Një stabilitet fals për të garantuar paktin e tri partive vetëm sa e zgjat agoninë e Shqipërisë, shton radhët e shqiptarëve që braktisin vendin,

rrënon shpresat për hapjen e negociatave me BE-në dhe e mban Shqipërinë në një gjendje ku eksplozioni social mund të ndodhë nga momenti në moment.

Nuk na duhet as një 'Crocodile'. Nuk na duhet më një dërgatë

europiane, një marrëveshje 'Mac+' dhe një 17-18 maj tjetër. Shqipërisë i duhet sot një reformim i thellë i sistemit politik si në demokracitë perëndimore dhe jo shpikje për një vend të botës së tretë ku vihet paqe mes tribuve në luftë për territore

dhe pasuri. Të tilla kemi parë që nga marrëveshja e Triestes në vitin 1997. Sot kemi të njëjtat parti që mbajnë peng vendin për interesat e tyre politike dhe ekonomike.


ZGJIDHJA kërkon nga ndërkombëtarët që të mos vijnë këtu me misionin dhe kostumin e zjarrfikësve. Ata mund ta shuanjnë flakët e momentit, por kështu nuk mund të ndalin rrënimin e Shqipërisë. Ata duhet të vijnë këtu si bartës dhe mbrojtës të vlerave europiane. Duhet të imponojnë me forcë, siç bëjnë me reformën në drejtësi, reformën elektorale bazuar në standardet dhe vlerat e një republike të vërtetë demokratike. Duhet të ndëjnë peshën e fajit, sepse në Shqipëri, si në asnjë vend tjetër demokratik, tri parti kanë në dorë procesin zgjedhor dhe ia kanë hequr popullit çdo të drejtë, kur vendet e Europës tashmë duan që gjithçka të ketë miratimin referendar, me votë direkte nga populli. Nëse nuk vijnë me këtë mision, më mirë të mos mundohen. Por të mos harrojnë se fiks 22 vite më parë, sollën mijëra forca pagëruajtëse për të mbrojtur dhe ushqyer me ndihma humanitare popullin shqiptar, që ishte çuar në krizë dhe anarki nga këto parti dhe nga kjo klasë politike. #ZgjidhjaPërShqipërinë

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

BLUE TOOTH
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Gazetë shtunë falas me
GAZETA SHQIPTARE

Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL
2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mappassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtë.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstremit në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

- 34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

- VERTIKAL
1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë
i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga fillbustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

VERTIKAL


- 35. E bukura e belle epoque.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rocshtar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor

- 9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremit në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërоре
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti




TIAN

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

9x9 Sudoku grid with numbers and empty cells.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Completed 9x9 Sudoku grid.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

Cryptogram puzzle with a grid of letters and a key below.

Argëtim filozofik

- Nëse duhej të mbyllim të gjithë idiotët në një dhomë të madhe, nuk do të kishte njeri që të mbyllte derën.
- Të gjitha rrugët janë të njëjta nëse nuk e di se ku shkosh.
- Të gjitha gjërat janë të vështira para se të bëhen të lehta.
- Kurrë mos lejo që dikush të jetë prioriteti yt, ndërsa ti për atë je një nga zgjidhjet alternative.
- Dembelizmi ecën aq ngadalë sa që varfëria e arrin menjëherë.
- Nëse prindërit punojnë dhe fëmijët e tyre i'a kalojnë mirë, atëherë nipërit e tyre sigurisht do të përfundojnë lypsarë.

Chënie të mençura

- Balta e vetme që na bën pis, është ajo që ua hedhim të tjerëve.
- Nëse pajtohem me ty, do të ishim të dy gabim.
- Nëse më interesonte se çfarë thonë pas shpinës time, nuk do ta kisha kthyer.
- Për të thënë të vërtetën, ka nevojë për dy: një për ta thënë, dhe një tjetër për ta dëgjuar.
- Disa, ndërsa dominojnë qytetet dhe popujt, bëhen skllevër para grave.
- Në jetë ekzistojnë: dashuria, urrejtja, mospërfillja. Jep çlarë të duash, merr çlarë jep.

Vertical crossword puzzle with words like ARTE, KUR, etc.

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



